**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**Nr. Protokolit: 01-060/01-0021268**
**Data: 27.03.2025**
**Për: Anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF**

## FTESË

Të nderuar anëtar/e,
Ju ftojmë që të merrni pjesë në mbledhjen e III-të të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Mbledhja do të mbahet me dt. 04.04.2025 (Premte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

## RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.02.2025.

3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë (Bajram) Muzlijaj me ¾, për qëllim të Interesit Publik: "Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun".

4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, për qëllim të Interesit Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë Lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit Lumbardh.

5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj (banesë), për qëllim të Interesit Publik: " Ndërtimi i Qendrës Kryesore Fmiljare".

6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela

Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-128/3 të dt. 24.03.2025

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës.

8. Rishqyrtimi dhe rekomandimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

9. Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Rregullore Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

10. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Plani të Zyrës për Komunitete për 2025.

11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç jan pranuar. (*Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Ejten, me dt.03.04.2025*).

KRYESUESI I KPF-së
z. Rexhep Kurtbogaj

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**Komiteti për Politikë dhe Financa**
**Nr. Protokolit: 01-060/01-0021268**
**Data: 27.03.2025**
**Për: Anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF**

## FTESË

Të nderuar anëtar/e,
Ju ftojmë që të merrni pjesë në mbledhjen e III-të të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Mbledhja do të mbahet me dt. 04.04.2025 (Premte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

## RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.02.2025.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë (Bajram) Muzlijaj me ¾, për qëllim të Interesit Publik: "Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun".
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronat e pronarëve privat me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, për qëllim të Interesit Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë Lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit Lumbardh.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj (banesë), për qëllim të Interesit Publik: " Ndërtimi i Qendrës Kryesore Fmiljare".
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela

Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-128/3 të dt. 24.03.2025

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës.

8. Rishqyrtimi dhe rekomandimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

9. Rishqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Rregullore Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

10. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Plani të Zyrës për Komunitete për 2025.

11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar. (*Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Ejten, me dt.03.04.2025*).

KRYESUESI I KPF-së
z. Rexhep Kurtbogaj

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-10517**
**Pejë, datë: 18 Shkurt 2025**

# PROCESVERBAL

Nga takimi i **II**-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **18 shkurt 2025**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtori i ÇPJ-së z.Arianit Krasniqi, drejtoresha e DKRS-së znj.Xhenet Syka Kelmendi, drejtoresha e Urbanizmit, znj. Arta Nallbani, drejtoresha e inspekcionit, znj. Edonjeta Berisha,Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, asistente administrative, znj.Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë. Po ashtu sqaroj se rendit të dites ju shtuan edhe 3 pika shtesë nga drejtoria e ÇPJ-së.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtaret prezent u miratua ky rend dite, me 6 vota pro, 3 anëtar nuk marin pjesë në votim,

Rendi i Ditës

1. 1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 20.01.2025.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit për dhënien e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve

nga Kuvendi i Komunës Pejë.

5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës.

6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me ½, Edison (Rexhep) Bala me ½ dhe Ismet (Murat) Bala me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit, përkatësisht realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK-së.

7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me 1/3, Bahrije (Nazmi) Bala me 1/3 dhe Edison (Rexhep) Bala me 1/3 si dhe Murat (Emin) Balaj me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit, përkatësisht realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK-së.

8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve Fisnk (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe Hapësrë e Hapur Publke, sipas PZHK-së.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e private të Bujar Nila me qëllim të formimit të rrugës dhe rregullimit të sheshit si interes publik, sipas PZHK-së.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Visar (Rifat) Tigani me ½ dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me 1/2 me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe hapësrë e hapur publke, sipas PZHK-së.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës për procesin e legalizimit të objekteve për vitin 2024 në Komunën e Pejës.
12. Informate mbi inspektimin e ndërtimeve ne Komunën e Pejës.

13.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

**1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 20.01.2025**

Nga të gjithë anëtaret prezent, me 8 votë pro, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim miratohet procesverbali i KPF-së i dt.20.01.2025

**3.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit për dhënien e autorizimit DKRS-së nga Kuvendi për publikimin e konkursit publik për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime.**

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: duke e mar parasysh se pika 3 është standarde dhe gjithashtu është e organizuar mirë në kuader të punës së kuvendit. Desha të j'u siguroj dhe garantoj se menihere pas aprovimit, pas seancës DKRS-së sikurse edhe vjet edhe ketë vit e pregatit konkursin 3 gjuhë, ku e publikon te faqja zyrtare e DKRS-së por njeherit edhe tek faqja zyrtare e komunes Pejë. Nuk është punë e lehtë por në një formë logjistika e DKRS-së është menagjuar mirë për me bë ketë punë, dhe desha të apeloj qysh nga sot mbasi jeni anëtar të KPF-së dhe keni ndikim social. Të filloni të prëgatitëni nese keni propozim dhe gjitha propozimet të jen të pregatitura në dosje të kompletuara, në menyrë që puna qoftë e komisionit por në anen tjeter puna administrative e DKRS-së të ketë mbarvajtje sa më të mirë. Besoj që e dini që afati i publikimit zgjatë 30 ditë dhe keni kohë të mjaftushme të mendoni dhe të gjitha propozimet shqyrtohen në menyrë të barabartë.

Z.Berat Ganiqi: ne kemi diskutu në shumë mbledhje të kuvendit komunal, sa here vin keto pika pa dyshim që duhet me u aprovu , mirpo është një shqetësim tjeter me rregulloren të cilen e rregullon ndarjen e dekoratave. Dhe nuk mundet secili anëtar me propozu çka don se po j'a kufizon edhe me nënshkrim, por edhe mbledhjen e nënshkrimeve të grupit të asambleistëve. Nese nuk gaboj duhen 11 nënshkrime për një propozim të asamblesitve ose 200 nënshkrime tek qytetarët. Po ashtu po ka shumë propozime që po shperndahen per një titull nderi 4 ose 5 përsona. Për mua është pa kuptim një dekorat me shpernda tek 5 përsona, sepse po e hup edhe vleren. Më mirë kishte me qenë një me u dekuru radhë pas radhe dhe vit pas viti, po mendoj që mbledhjen e radhes me ardh me disa ndryshme në rregullore dhe me u hek disa prej diskriminimve që kanë qenë!

Z.Labinot Panxha: tek titujtë që ndahen në rregullore përcakton qartë dmth titulli i njejt nuk i jepet 10 përsonave dhe kjo ka ndodhë heren e kaluar, dhe nuk ish dasht me ndodh sepse po i hup vlera e titullit nese e shpërndan tek dhejtë përsona. Për ketë pjesë ish dasht me pas kujdes dhe me mar në konsideratë dhe me rregullu!

Znj. Xhenet Syka Kelmendi**:** unë e kam thën disa here që DKRS-së në ketë rast nuk është organ vendimarrës, ka vetem një anëtar të komisionit në kuadër të komisionit gjithëpërfshirës. Nuk është ajo drejtoria që ka vendos për një ose më shumë tituj. Në rregulloren shkrun që vetem në vitet jubilare mund të rritet një titull deri në pesë here. Tash e kemi piken tjeter kur të gjitha partit e propozojnë një anëtar të komisionit. Komisini është i krijuar nga kuvendit, dhe është organi vendimarrës i cili i shqyrton mirë aplikacionet që vin në dosje dhe pastaj vendos. Ndërsa vërejtjen sa i perket që të ipen vetem një titullë sa i perket rregulores, ju inkurajoj që të diskutoni në seancën e rregulltë të kuvendit, dhe keni të drejtë absolute ta votoni si asambleistë.

Z.Labinot Panxha: fjala është për titujt e nderit që i jepen një përsonit, dhe ata që janë në komision munden me qenë profesioneve të ndryshme dhe munden mos me qenë jurist. Mirpo ju si drejtori e keni diskretcionin e juve, dhe duheni me interpretu atë rregullor, nëqoftëse ai

komision ju referohet. Munden me qenë 5 anëtar të komisionit që nuk e kuptojnë dhe nuk din me interpretu menyren qysh na po bisedojmë!

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: athere gjejini anëtaret që  e kuptojnë!

Z.Labinot Panxha: ajo se qka duhet është interpretimi dhe ajo se qka është e cakutume behet vetem nëqoftese është dikush prej drejtorisë ose prej kuvendit ai i cili i asiston për interpretim dhe j'a sqaron atë që sot jemi duke e diskutu ketu! Një titullë nderi i shperndahet në vitë një personi dhe ata duhet me pas të qartë, sespe po  bëhet shumë aty kur po ndahen titujtë 100 tituj nderi po i ndahet secilit dhe po i hup rëndësia.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 8 votë pro dhe 1 anëtar nuk mer pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim.

**4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fillimishtë problemi është  i qartë përgjegjësi për zbatimin e rregullores dhe te formimi i ketij komisionit. Ndërsa drejtoria e kultures i ndihmon proceduren për aplikim. Po ashtu e ceket të ndahet çmimi për një përson mirpo ka ndodhë që  me dakordimin e komisionit me ju jep ma shumë çmimi, se ka pas ma shumë personalitet dhe nuk kanë mujt me i nda dhe unë e kuptoj shumë mirë edhe komisionin! Ka qenë shumë e nevojshme plotësim/ndryshimi i rregullores, mirpo don kohë shumë dhe nuk mundemi me arrit brend periudhes dhe duhet me vazhdu me rregulloren e njejtë.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: në faktë ju e dini mirë që komisioni formohet  nga kuvendi dhe është organ vendim marrës, dhe ju kisha inkurjau shumë që edhe brenda partive politike të të keni formatin dhe të zgjedhni përsonat që i kontribojnë komisionit. Prap po e perserit DKRS ka qenë veq një votë dhe asnjehere nuk ka qenë kryesuse e komisionit. Po ashtu edhe kryesinë e komosionit do ta mer dikush nga anëtaret e  kuvendi! Por DKRS do të ndihmoj me administrat dhe me logjistikë, por një tjeter inkurajim është që anëtaret kur i zgjedhni  që anëtaret kur ta marin ftesen e takimve me nda një kohë për takim, sespe nuk takohen me teper se 3 ose 4 here gjatë gjithë procesit. Prandaj kisha dasht që me gjet kohë  sespe ftesa ju shkon një javë më heret dhe kisha dasht me gjet kohë t'i kontribojnë ketij komisioni, sepse uke kontribuar edhe parimet bëhen më të mira. Po ashtu ju kisha inkurju që në seancën e rregulltë me ngrit zerin dhe jehonë pak edhe te asociacionet dhe nuk jemi qytet i madhë  njihemi mes vete dhe hatermbetjet e mëdha, dhe vet anëtaret e komisionit kanë votu me u zgjedhë disa tituj!

Z.Labinot Panxha: ne vetem erdhem te qajo që për hatermbetje duhet me u shkell rregullorja dhe jo çdohere është e domosdoshme me u shkel një rregullore që përcakton diqka, dhe  anëtaret e komisionit duhet me qen në dijeni që nuk duhet me u shkel rregullorja. Sepse ata athere nuk kanë as keqardhje as hatermbetje por i ndajnë tituj sipas rregullores kush do që e ka propozu i pari a i dyti qysh i plotëson kriteret.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: ky është roli i kuvendit, sepse komisioni nuk është i një partie por komisioni është një organ drejtpërdrejtë i kuvendit, për ata po ju them debatoni në seancën e rregulltë.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 8 votë pro dhe 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit propozimi i Kryesuesit për formim e komisionit të veçantë për ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, mirënjohjeve dhe falënderimeve nga Kuvendi i Komunës Pejë.

**5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës.**

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për një parcelë e cila shtrihet në fshtain Llutogllavë me nr. parcele 00167-6 me siperfaqe 112258m2, është prezentu për dhënje në shfrytëzim për 30 vjet, për panela solore me negocim nga kryetari i komunes dhe kompanisë LIMAK, materialin e keni marr e kemi aty edhe Draft-marrveshjen sigurisht keni pas rast me shiku!. Përafersishtë sipas asaj që jemi marr vesh diku rreth 40 mijë euro në vitë paguajnë për shfrytëzimin e hapsires, po ashtu i ofrojmë asistencë dhe kyqje në asetet e instiucionit elektrodistrribucionit në atë pjesë ku është e planikifume si zonë industriale.

Z.Labinot Panxha: veq disa pyetje i kam shumë konkrete a është në listen e pronave dhe cili është interesi publik? A është interes i KEDS-it a i Komunes? Përse për 30 vite e jo më pak qysh përcaktohet me ligj ?

Z.Arianit Kraniqi: harrova me cekë është pjesë e listen të ciles e votojmë ne ne kuvend është parapa për 35 vite ndërsa marrveshja po bëhet për 30 vite, 5 vite më pak sepse korporata që e ka shpreh interesimin ashtu e ka mendu. Sigurishtë investimet e mëdha për një afat më të shkurt nuk kishin mujt me u bind as ata as kryetari për me dhënë token në shfrytëzim. Ky është interes edhe i komunës edhe i kompanisë, interesë i dyanëshem. Po ashtu vlera që llogaritet 1800 euro për një hektar për dhënje në shfrytëzim.

Z.Berat Ganiqi: unë dashta një pyetje më ndryshe duke e ditur që në Llutogllavë është deponia e mbeturinave dhe duke e ditur qfarë reziku kanoset! A keni marr ndonjë pëlqim nga ekspertet për këto panele solare? Mos po krijohet ndonjë problematik sespe terheqja e rrezeve solare dhe deponia e mbeturinave aty nese shperthen a keni marr parasysh rrezikun?

Z.Arianit Krasniqi: unë se kam bo vlersimin dhe nuk jam ai që e bëj vlersimin, e di që parakushtet i kanë kqyr ata që janë eksperta të lamisë KEDS dhe LIMAK. Ndërsa në aspekte teknike nuk di qka me të thonë, vetem që e di që është një fushë aty me panele solare paraprakishtë dhe kjo është afer për pjesen që po flasim.

Z.Berat Ganiqi: mirë është me u konsulltu me dikend se përzirja e këtyre materieve paraqet rrezik dhe për ketë e kam friken. Për ata me engjertike që meren sepse kompanisë nuk i besoj sespe ata e kqyrin vetem interesin e vet!

Z.Arianit Krasniqi: kjo është qka e kemi prezentu, ndërsa për pjesen tjeter ata që vin me bo një investim kapital i kanë parapa të gjitha parakushtet.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës **.**

**6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me ½, Edison (Rexhep) Bala me ½ dhe Ismet (Murat) Bala me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit, përkatësisht realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK-së.**

Z.Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për një propozim këmbimin e pronave, parcelat komunle me parcelat e pronarve privat ketu në korz në qender të Pejës. Për ngstrat kadastrale komunale me nr.2257/10 me siperfaqe 31m2 ZK Pejë, 6191/2 me siperfaqe 11m2 ZK Pejë, e cila është propozuar të këmbehet me ngastra kadastrale nr. 2261/4 me siperfaqe 9m2 dhe 2261/8 me siperfaqe prej 13 m2 në pronësi të Jeton(Rexhep) Bala1/2 dhe Edison(Rexhep)Bala ½. Po ashtu edhe ngastrat kadastrale me nr.2261/6 me siperfaqe 7m2 dhe 2261/10 me siperfaqe 13m2 në pronësi të Ismet (Murat) Bala, të cilat meren me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumit Lumbardh si interes sipas PZHK-së.

Z.Labinot Panxha: ne të gjithë e dim që nga ura e korzes dhe deri te milot bashqe ky shteg e dim që ku pronat janë mar 3 metra pronarve dhe në këmbim kta me vazhdu kah pjesa tjeter e korzes. Po ashtu e pash diku edhe vlersimin 750 euro m2 shumë lirë në qender të Pejës zonen 1, spo më duket në rregullë dhe cdo here po del vlera ma e madhe e prones së pronarit përsona fizikë se sa e komunes në të njejten zonë, shumë parregullësi!

Z.Arianit Krasniqi: vlera është e njejt, e nese del në zonen tjeter të bistrices athere është ndryshon vlera!

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me ½, Edison (Rexhep) Bala me ½ dhe Ismet (Murat) Bala.

**7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me 1/3, Bahrije (Nazmi) Bala me 1/3 dhe Edison (Rexhep) Bala me 1/3 si dhe Murat (Emin) Balaj me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit, përkatësisht realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK-së.**

Z.Arianit Krasniqi: vendi është pothuajse i njejt por në anen e kundërt. Bëhet fjalë për këmbimin e prones komunale me nr.6333/2 me siperfaqe 35m2 ZK Pejë,e cila propozohen për këmbim me ngastrat kadastrale me nr. 2301/1 në siperfaqe 50m2, ngastra me nr.2301/3 me siperfaqe 14m2 dhe ngastra kadastrale me nr.2301/2 me siperfaqe 20m2 të bashkëpronarve privat me 1/3 me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit, përkatësisht realizimit të shtegut të ecjes buzë lumit "Lumbardhë" sipas PZHK-së.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së

paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private Jeton (Rexhep) Bala me 1/3, Bahrije (Nazmi) Bala me 1/3 dhe Edison (Rexhep) Bala me 1/3 si dhe Murat (Emin) Balaj.

**8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve Fisnk (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe Hapësrë e Hapur Publke, sipas PZHK-së.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe ktu bëhet fjalë për këmbi materialin e keni marrë, drejtori është prezent ër më shumë sqarime!

Z. Arianit Krasniqi: bëhet fjalë për propozim këmbimi në mes të komunës së Pejës dhe prones private të pronarve Fisnik (Rexhep) Elshani dhe Edona(Rexhep ) Elshani. Objekt këmbimi do të jetë ngastra kadastrale me nr.615/1 me siperfaqe 1410m2 ZK Vitomericë pronë komunale, e cila priopozohet të këmbehet me ngastrat kadastrale të pronarve privat me nr.2145/2 me siperfaqe 188m2 ZK Pejë, nr.2146/2 me siperfaqe 55m2 dhe nr.2146/4 me siperfaqe prej 85m2, të cilat do të meren me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe Hapësrë e Hapur Publke, sipas PZHK-së.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve Fisnk (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani.

**9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e private të Bujar Nila me qëllim të formimit të rrugës dhe rregullimit të sheshit si interes publik, sipas PZHK-së.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë është bashkangjitur rendit të dites dhe materialin ju kemi dërgu , për sqarim shtesë prezent është drejtori!

Z.Arianit Krasniqi: fillimishtë kërkoj falje për vonesë të materialit sepse vlersimi na ka ardh me vonese! Bëhet fjalë për këmbimin e pronës së pronarit privat dhe prones komunale, objekt i këmbimit është ngastra me nr.6191/5 me siperfaqe 37m2 dhe 6191/6 me siperfaqe 20m2 ZK Pejë pronë komunale të cilat propozohen për këmbim me ngsatren kadastrle nr.4874/30 me siperfaqe 70m2, pronë private e z.Bujar Nila me qëllim të formimit të rrugës dhe rregullimit të sheshit si interes publik, sipas PZHK-së. Drejtori i prezenton ortofotot sipas materialit.

Z.Berat Ganiqi: materiali edhe pse me vonesë e pash pak, deshta me kerku si sqarim kur e ka mar pronari ketë pronen dhe cili Bujar Nila sepse janë dy përsona? A është vëllai i drejtorit të kadastres? Prej kurshit është bë pronar Bujar Nila?

Z.Arianit Krasniqi: është bë pronar është me dt. 17.12.2024

Z.Berat Ganiqi: dmth në vitin 2024 është bë pronar për dy parcela dhe ju po ja mundësoni në vlerë 80 mijë e 250 euro me këmby, për një parcelë që ja kanë vlersu për 9 mijë e 800 euro? Nuk

po ja jepni një parcele, por dy kjo është biznisë dhe me kish ardh mbare me bo qesi sende! Po mendoni qe ska kurfar ligji as kurgjoo, po ja jep dy parcela me vlerë më të madhe se ky që e ka 9.800euro, po ja bën dy këmbime njëra po kushton 20 mijë e diqka e tjerat aty afër 60 mijë euro, dhe po vjen ktu po thush jo 9.800? Në rregullë ketij po ja vlersojnë por kur ja jep 2 parcela dihet për qka bëhet qëllimi i këmbimit me u arrit përafërsisht. Pastaj po ja mundësoni 70 mijë euro dhe me bo qet biznis trasnsakcioni ketij pronarit se spo di as kush është pronari. Kjo është e patolerushme!

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e private të Bujar Nila.

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Visar (Rifat) Tigani me ½ dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me 1/2 me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe hapësrë e hapur publke, sipas PZHK-së.**

Z.Aranit Krasniqi: këmbimi do të bëhet përmes komunes së Pejës dhe pronës private të pronarve Visar Tigani dhe Kreshnik Tigani, objek këmbimi do të jetë ngastra kadastrele nr.6191/3 me siperfaqe 9m2 dhe nr.2257/6 me siprfaqe 23m2 pronë Komunale, e cila propozohet të këmbehen me pronen private me nr.2262/5 me siperfaqe 13m2 dhe nr.2262/7 me siperfaqe 22m2 ZK Pejë, në pronësi të bashkëpronarve të lartëcekur, me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - Shetitore dhe hapësrë e hapur publke, sipas PZHK-së.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim propozim i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Visar (Rifat) Tigani me ½ dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me ½.

**12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës për procesin e legalizimit të objekteve për vitin 2024 në Komunën e Pejës**.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr paraprakisht, drejtoreshen e keni prezent për sqarime shtesë!

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit informata për procesin e legalizimit të objekteve për vitin 2024 në Komunën e Pejës.

**13. Informate mbi inspektimin e ndërtimeve ne Komunën e Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sa i perket pikes informatë mbi inspektimin e ndertimve materialin e keni marr sot, drejtoreshen e kemi prezent nese ka dikush pyetje apo sqarime!

Nga të gjithë anëtaret prezent me 8 votë pro dhe 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit informata mbi inspektimin e ndërtimeve ne Komunën e Pejës.

**14.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:**

Z.Labinot Panxha: unë e kam një pyetje pasi që janë prezent drejtoresha e inspekcionit dhe drejtori i ÇPJ-së, në rr.Mbreti Pirro egzistojnë parkingjet dhe në ato parkingje janë vendos penguesit që disa qytetarë i kanë përvetusu i kanë bo për veti. Unë, i kam mar disa mesazhe nga qytetarët që jetojnë në atë pjesë, dhe e kanë të pa qartë se ku i kanë marr lejet dhe kush ju ka lshu leje me vendos me vendos pengus dhe me përvetësu parkingun që është pronë komunale.

Z.Arianit Krasniqi: prej neve nuk kanë marr leje porndoshta kanë marr leje nga sherbimet publike, ata në bazë të rregullores kanë drejtë me i lshu parkingje individuale.

Z. Labinot Panxha: të kuptohemi dmth atë pjesë keni pas me lëshu për shfrytëzim, me çfare ligji apo rregullore drejtori lëshon leje për ato parkingje, përderisa ajo pronë është në listë për me u jep në shfrytëzim ketë pjesë me ma sqaru ? Po ashtu edhe pytje për drejtoreshen e inspekcionit a ka dal ndonihere me inspektu atë rrugë dhe a ka marr ndonjë ankese prej qytetarëve që janë në atë rrugë, dhe a ke vepru?

Znj.Edonjeta Berisha: sa i perket inspektimeve na i kemi bo inspektimet sepse edhe ne kemi marr ankesa! Mirpo ata banorë i përkasin pëlqimet siq e ceki edhe drejori që drejtoria e sherbimeve publike i ka lëshu disa pëlqime, ku ata kanë bo kërkesë dhe për atë pëlqim paguajnë një tarifë të cilët ata ja përcaktojnë .

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:10 h.**

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësja,** | **K R Y E S U E S I,** |
| **znj. Donjeta Morina** | **z. Rexhep Kurtbogaj** |
| _________________ | _____________________ |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIK OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

# PLANË PROGRAMI I PUNES - PLAN RADA

## DETYRAT DHE OBLIGIMET TË PUNËS PËR VITIN 2025 - ZADACI I OBAVEZE ZA 2025 GODINU

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM-OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

| Nr<br>Br | Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës<br>Opis poslova i zadataka | Njësia matëse<br>Jedinicamjere | Planifikimi për 2025<br>Planirano za 2025 | PERIUDHA KOHORE E REALIZIMIT | | | | | | | | | | | | Verejtje<br>Napomena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Janar<br>Januar | Shkurt<br>Februar | Mars<br>Mart | Prill<br>April | Maj<br>Maj | Qershor<br>Jun | Korrik<br>Jul | Gusht<br>August | Shtator<br>Septembar | Tetor<br>Oktobar | Nëntor<br>Novembar | Dhjetor<br>Decembar | |
| 1 | Bashkëpunim - Takimet me Ministrin për Komunitete dhe Kthim<br>Saradnja- sastanci sa Minstarstvom za Zajednice i Povratak | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **28** | 1 | 3 | 2 | 3 | 2 | 4 | 2 | 0 | 3 | 2 | 3 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Vizitat ne teren me personat-familjet te kthyera<br>Posjete povratničkih porodica | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **29** | 1 | 2 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 2 | 4 | |
| | | Realizume<br>Ralizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Bashkëpunim me OJQ qe meren me kthime<br>Saradnja sa NVO koje se bave povratkom | Nr.takimeve<br>Br. sastanaka | **20** | 1 | 2 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 0 | 2 | 3 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal pë Kthim<br>Ucesce u Opstinskoj Komisiji za Povratak | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Bashkëpunim - Takimet më Ministrin Puneve te Brendshme<br>Saradnja-Sastanci sa Ministarstvom Unutrašnjih Poslova | Nr.takimeve<br>Br.poseta | **29** | 2 | 2 | 3 | 3 | 2 | 3 | 3 | 0 | 3 | 2 | 3 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Vizitat ne teren me personat-familjet te riatdhesuara<br>Posjete repatriranih porodica | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **29** | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 2 | 2 | 3 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | Bashkëpunim me OJQ qe meren me riintegrimin e personave të riadthesuar<br>Saradnja sa NVO koje se bave reintegarcijom repatriranih osoba | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | 25 | 1 | 2 | 3 | 3 | 2 | 3 | 2 | 0 | 3 | 2 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal pë Riintegrim<br>Ucesce na Opstinskoj Komisiji za Reintegraciju | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | Bashkëpunim me Zyren e Punesimit për projektet e personave të riadthesuar<br>Saradnja sa Zavodom za zapošljavanje na projektima repatriranih lica | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 10 | Takime me perfaqetsuesit e bashkësive lokale<br>Sastanci sa predstavnicima lokalnih zajednica | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | Vizita ne teren për të gjitha komunitetet për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre.<br>Terenske posjete svim zajednicama kako bi se dobile informacije o njihovim problemima i potrebama. | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **29** | 2 | 3 | 3 | 2 | 3 | 2 | 3 | 1 | 3 | 3 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | Bashkëpunim me Ministrit të ndryshme pran Qeverin Kosovës si dhe me Zyren e Kryeministrit<br>Saradnja sa različitim Ministarstvima pri Vladi Kosova kao i Kancelarijom Premijera | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Pjesëmarja në Komitete të Formura<br>Učešće na formiranim komitetima | Nr.takimeve | **19** | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 0 | 1 | 2 | 1 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 14 | Bashkepunimi me Drejtorit Komunale<br>Saradnja sa Opštinkim Direktoratima | Nr.takimeve | **27** | 2 | 3 | 2 | 3 | 2 | 3 | 2 | 0 | 2 | 3 | 3 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 15 | Bashkëpunim me Qendren Për Punë Sociale<br>Saradnja sa Centrom za socijalni rad | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **31** | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 2 | 3 | 4 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 16 | Bashkëpunim me Policin e Kosoves, FSK dhe KFOR<br>Saradnja sa Policijom Kosova, KBS i KFOR-om | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **33** | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 3 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |
| 17 | Bashkëpunim me ZKKK të Komunave tjera<br>Saradnja sa OKZP drugih opština | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **22** | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 | 2 | 2 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | | | | | | | | | | | | | | |

**Shefi I Zyres**

**Dipl.Ing.Sabahudin Ciriković**

# KOMUNA E PEJËS

RAPORTI VJETORË 2024

**DREJTORIA**

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

**SABAHUDIN CIRIKOVIĆ**

EMRI I SHEFIT TË ZYRES KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

**GAZMEND  MUHAXHERI**

EMRI I KRYETARIT TË KOMUNËS:

| Fusha | Aktiviteti | Rrezulltati |
|---|---|---|
| Monitorimi i sistemeve Intranet dhe online MPB-es | Monitorimi ditor i Intranetit (Sistemi Elektronik) | Në periudhën janar - dhjetor 2024, ZKKK - Zyra Komunale per Komunitete dhe Kthim ka pranuar 1 kerkes. |
| | Monitorimi ditor i sistemit online të Ministrisë Punëve të Brendshme për personat e riatdhesuar në orën 08:00 dhe 14:00. | Sektori për Riintegrim dhe të Drejtat e Komuniteteve janë pranuar 13 raste të riatdhesimit përmes sistemit online. |
| | Numri i përgjitheshëm i përsonave të riatdhesuar për vitin 2024 | Për periudhen kohore Janar - Dhjetor për vitin 2024 sipas etnicitetit gjithsej janë :<br>Shqiptar - 4 Individ<br>Egjiptian - 3 individ dhe 1 familje me 9 ANT<br>Rome - 3 Individ dhe 2 familje me 16 ANT<br>Ashkali - 1 Individ |
| **Fusha** | **Aktiviteti** | **Rrezulltati** |
| Bashkëpunimi me MPB-së si dhe me zyrën rajonale të MPB-së | Bashkëpunimi i përditshëm lidhur me sistemin online, problemet apo rastet që lidhen me riintegrimin e personave të riatdhesuar. | Bashkëpunimi ditor (konsultimet) me koordinatorin rajonal Arben Gorani lidhur me verifikimin në terren brenda 5 ditëve të personave të riatdhesuar sipas rregullores nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe për menaxhimin e programit të riintegrimit |
| | Bashkëpunimi me MPB -sektorin e menaxhimit të rasteve rajonale | Bashkëpunimi me MPB -sektorin e menaxhimit të rasteve rajonale, lidhur me verifikimin e të dhënave të rasteve të riatdhesuar si dhe plotësimin e të dhënave të të njëjtit në sistemin online. |
| | Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, ka organizuar punëtori mbështetet nga GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. | • "Avancimi e bashkëpunimit nder-regjional, ngritje e kapaciteteve të akterëve lpkalë për këshillim efektiv dhe zbatimin e plitikave të Riintegrimit.<br>• Verësimin e Nevojave rreth procesit të Riintegrimit dhe Integrimit të Riatdhesuarve", Punëtoria ka përfshii sesione të thelluara, diskutime dhe ushtrime praktike, me synim mbështetjen e akterëve lokalë në zbatimin e suksesshëm të këtyre politikave.<br>• "Trajnim për Qarkoren Informative për Zbatimin e Rregullores QRK NR. 22/2020 Për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar" Implementimi i Planeve Komunale të |
| **Fusha** | **Aktiviteti** | **Rrezulltati** |
| Bashkëpunimi me Minstrin per Komunitete dhe Kthim (MKK) | Takimet e rregullta me MKK-në | Takimet e rregullta me MKK-në lidhur me procesin e kthimit dhe zgjidhje të qëndrueshme. |
| | Punëtori për zyrtarët e ZKKK-ve | Perdorimi e bazës së të dhënave të MKK-së |
| | Takim rajonal koordinues | Strategjinë për Mbrotjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre 2023-2027," me një fokus të veçantë në rolin e komunave në zbatim, monitorim dhe raportim. |
| **Fusha** | **Aktiviteti** | **Rrezulltati** |
| Bashkëpunimi me nivelin qendror | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/MAPL, në bashkëpunim me Organizatën "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve", "Terre des hommes" dhe "HEKS" ka organizuar një tryezë diskutimi. | "Vlerësimit të kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e margjinalizuara/MAPL dhe "Rregulloren e (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil". |
| **Fusha** | **Aktiviteti** | **Rrezulltati** |
| Bashkëpunim me nivelin Lokal | Bashkëpunim me Komuna tjera - ZKKK | Gjate vitit kemi vizituar ZKKK ne Komunat Istog, Deçan, Klinë, Gjakove dhe Prizren. Qellimi i keyre vizitave ishte shkembimi i përvojave, si dhe ndarja e informatave rreth punve të zyrës. |

| | Aktiviteti | Rezultati |
|---|---|---|
| Bashkëpunimi me Policin e Kosovës, FSK-në dhe KFOR -in | Takime me Polici dhe FSK-es | Takime të rregullta mujore për çështje të komuniteteve ne komunën e Pejës. |
| | Takim me KFOR-in | Takim me KFOR-in lidhur më pozitën e komuniteteve ne komunën e Pejës. |

| Fusha | Aktiviteti | Rrezulltati |
|---|---|---|
| Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare | Bashkëpunim me IOM-in lidhur me projektin për RRK V | Për këtë vit kemi pasur 4 raste të reja të interesuar për kthim nga Mali i Zi. Në këtë vit nuk kemi pasur raste të reja kthimi. Është ndërtuar një shtëpi (rast i vjetër) nga ky program në Gorazhdec, nga komuniteti serb - 3 anëtarë të familjes. |
| | Bashkëpunim me IOM-in lidhur me projektin "Stabilizim Komuniteteve" | • Vlerisimin në teren aplikuesve per projekt.<br>• Pranim dorezimi I projektit Furnizim me mjete te konkretizimit/Laborator Fizik - Kimi- biologji per shkollen fillore ne Novoselle - Peje. |
| | Fondacioni Jahjaga në koordinim me Zyrën e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë dhe Zyrën e UNDCO-së ka organizuar takim me perfaqesuesi KKPeje dhe komunitetet e kthyera në Pejë | "Investimi në fuqizimin ekonomik për të përmirësuar mirëqenien, përfshirjen sociale dhe qëndrueshmërinë në mes grave dhe të rinjve të kthyer". Qëllimi është shqyrtimii rrugët e mundshme për të lehtësuar përfshirjen e këtyre individëve në mundësi të zhvillimit sociAo-ekonomik. |
| | Agjencisë për Zhvillim Rajonal-Perëndim, ka organizuar tryezën e rrumbullakët "Prioritetet zhvillimore të OSHC-ve nga Rajoni Perëndimorë dhe bashkëpunimi i ardhshëm me MZHR", si takim i përbashkët i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me Organizatat e Shoqërisë Civile nga rajoni perëndimorë i Kosovës. | Qëllimi i tryezës me OSHC-të e rajonit është diskutimi i mundësitë e bashkëpunimit me MZHR në realizimin e qëllimeve të përbashkëta zhvillimore, mundësitë e financimit të aktiviteteve të OSHC-ve për qëllime të zhvillimit rajonal të balancuar, si dhe implikimet ligjore nga Ligji i ri për Zhvillim Rajonal dhe aktet e ndërlidhura nënligjore, sipas agjendës së bashkangjitur. |
| | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) misioni në Kosovë ka organizuar punëtori | • Vlerisimin"Punëtorinë dy ditore në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që qon në Terrorizëm (PEDhRT), në komunën e Pejës" . Punëtoria synon fuqizimin e grave në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.<br>• "Ngritja e kapaciteteve për rritjen e aftësive te punësimit të grave të kthyera dhe grave nga komunitetet jo shumice si përfitues të iniciativave socio-ekonomike nga rajoni i Pejës dhe Mitrovicës" |
| | Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS) | "Përmirësimin e performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime duke kontribuar në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve".Një ndër komponentet e rëndësishme të projektit ka të bëjë me angazhimin e qytetarëve në procesin e planifikimit të buxhetit komunal. |

| Fusha | Aktiviteti | Rrezulltati |
|---|---|---|
| Bashkëpunimi me drejtoritë komunale | • Pjesëmarrje ne Komision Komunal për Riintegrim (KKR)<br>• Komisioni Komunal për Kthim (KKK)<br>• Komiteti për Komunitete (KK)<br>• Komitet për politik dhe financa (KPF)<br>• Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)<br>• Kuvendi Komunal<br>• Komision Komunal për Mekanizmit Koordinues Komunal kunder Dhunes ne Familje | • KKR ka mbajtur 2 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar 2 raste (Kërkesë);<br>2 Kërkesa për Akomodim<br>• KKK ka mbajtur 1 takime dhe janë shqyrtuat 1 raste.<br>**Nacionalitet**<br>Egjiptian - 1<br>• ZKKK ka mare pjes ne 11 takime te regullta ne Komitetin për Komunitete (KK)<br>• Gjatë kësaj periudhe kohore ZKKK-ja ka marr pjese ne pesë takime ne Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).<br>• ZKKK ka mare pjes ne 2 takime te regullta ne KKomitet për politik dhe financa (KPF) |

| Fusha | Aktiviteti | Rrezulltati |
| --- | --- | --- |
| Shërbimeve te tjera ZKKK-ës | Pranimi i paleve | ZKKK ofron shërbime, këshillon palët në baza ditore si për kthimin, riintegrimin dhe të drejtat e komuniteteve |
| | Vizita e refugjatve ne Milin eZi | • Vizita "Shko informo" ne Herceg Novi |
| | ZKKK-ja e realizon vizita ne teren të kthyerve, personave të riatdhesuar dhe të gjitha komuniteteve për të parë riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre. | Vizitat janë bërë në tere teritorin e Komunes se Pejës |
| | Financat e ZKKK-ës | • Sipas kërkesave nga Buxheti i Zyrës Komunale për Komunitetet dhe Kthim, të gjithë kërkesat shqyrtohen dhe azhurohen më kohë. |

| Emri Mbiemri | Emri | Mbiemri | Raporti i punës 2015 | Planifikimi për 2016 |
|---|---|---|---|---|
| Fatmir Asllani | Fatmir | Asllani | ✓ | |
| Besim Avdimetaj | Besim | Avdimetaj | ✓ | |
| Jeton Abazaj | Jeton | Abazaj | ✓ | |
| Artan Gashi | Artan | Gashi | ✓ | |
| Salih Lajçi | Salih | Lajçi | ✓ | |
| Mustaf Nila | Mustaf | Nila | ✓ | |
| Petrit Loci | Petrit | Loci | ✗ | |
| Suzana Muriqi | Suzana | Muriqi | ✓ | |
| Engelbert Zefaj | Engelbert | Zefaj | ✓ | |
| Muhamet Mahmutaj | Muhamet | Mahmutaj | ✓ | |
| Edmond Shala | Edmond | Shala | ✓ | |
| Ukë Selimaj | Ukë | Selimaj | ✓ | |
| Mehdi Mulaj | Mehdi | Mulaj | ✓ | |
| Demë Dashi | Demë | Dashi | ✗ | |
| Sabahudin Cirikovic | Sabahudin | Cirikovic | ✓ | |

| Drejtoria | Shkurtes |
|---|---|
| Drejtoria e Administratës dhe Personelit | DAP |
| Drejtoria Komunale e Arsimit | DKA |
| Drejtoria për Buxhet dhe Financave | DBF |
| Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik | DZHE |
| Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit | DUMM |
| Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi | DKGJ |
| Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | DSHMS |
| Drejtoria për Integrime dhe Diasporë | DID |
| Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | DKRS |
| Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim | DKMSH |
| Drejtoria për Çështje Pronësorë Juridike | DSHPJ |
| Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike | DPKSHP |
| Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidro-Ekonomi | DBPH |
| Drejtoria për Inspekcion | DI |
| Zyra për Komunitet dhe Kthim | ZKK |

| EMAIL | Nr Kontaktues | Ngjyra |
|---|---|---|
| fatmir.asllani@rks-gov.net | 049 429 000 | |
| besim.avdimetaj@rks-gov.net | 049 359 000 | |
| jeton.abazaj@rks-gov.net | 049 364 000 | |
| artan.gashi@rks-gov.net | 049 469 000 | |
| salih.lajci@rks-gov.net | 049 475 000 | |
| Mustafe.Nila@rks-gov.net | 049 489 000 | |
| petrit.loci@rks-gov.net | 049 112 333 | |
| suzana.muriqi@rks-gov.net | 049 479 000 | |
| engelbert.zefaj@rks-gov.net | 049 476 000 | |
| muhamet.mahmutaj@rks-gov.net | 049 486 000 | |
| edmond.shala@rks-gov.net | 049 451 000 | |
| uke.selimaj@rks-gov.net | 049 481 000 | |
| mehdi.mulaj@rks-gov.net | 049 436 000 | |
| deme.dashi@rks-gov.net | 049 471 000 | |
| sabahudin.cirikoviq@rks-gov.net | 049 142 765 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIK OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

# PREALIZIMI I LANË PROGRAMIT TË PUNESPËR VITIN 2024

# REALIZACIJA PLANA RADA ZA 2024 GODINU

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM-OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

| Nr<br>Br | Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës<br>Opis poslova i zadataka | Njësia matëse<br>Jedinicamjere | Planifikimi për 2024<br>Planirano za 2024 | PERIUDHA KOHORE E REALIZIMIT | | | | | | | | | | | | Verejtje<br>Napomena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Janar<br>Januar | Shkurt<br>Februar | Mars<br>Mart | Prill<br>April | Maj<br>Maj | Qershor<br>Jun | Korrik<br>Jul | Gusht<br>August | Shtator<br>Septembar | Tetor<br>Oktobar | Nëntor<br>Novembar | Dhjetor<br>Decembar | |
| 1 | Bashkëpunim - Takimet me Ministrin për Komunitete dhe Kthim<br>Saradnja- sastanci sa Minstarstvom za Zajednice i Povratak | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **26** | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 2 | 0 | 3 | 2 | 3 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | 29 | 1 | 3 | 2 | 3 | 2 | 4 | 2 | 1 | 3 | 2 | 3 | 3 | |
| 2 | Vizitat ne teren me personat-familjet te kthyera<br>Posjete povratničkih porodica | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **30** | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 4 | 2 | 0 | 3 | 3 | 3 | 2 | |
| | | Realizume<br>Ralizovano | **29** | 1 | 2 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 | 1 | 3 | 3 | 2 | 3 | |
| 3 | Bashkëpunim me OJQ qe meren me kthime<br>Saradnja sa NVO koje se bave povratkom | Nr.takimeve<br>Br. sastanaka | **21** | 2 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 | 2 | 2 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | **20** | 1 | 2 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 0 | 2 | 3 | 2 | 2 | |
| 4 | Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal pë Kthim<br>Ucesce u Opstinskoj Komisiji za Povratak | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | **1** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | |
| 5 | Bashkëpunim - Takimet më Ministrin Puneve te Brendshme<br>Saradnja-Sastanci sa Ministarstvom Unutrašnjih Poslova | Nr.takimeve<br>Br.poseta | **30** | 2 | 3 | 3 | 3 | 2 | 3 | 2 | 0 | 4 | 2 | 3 | 3 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | **29** | 2 | 2 | 3 | 3 | 2 | 3 | 3 | 1 | 3 | 2 | 3 | 2 | |
| 6 | Vizitat ne teren me personat-familjet te riatdhesuara<br>Posjete repatriranih porodica | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **31** | 3 | 3 | 3 | 2 | 3 | 4 | 3 | 0 | 3 | 3 | 2 | 2 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | **29** | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 3 | 2 | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | |
| 7 | Bashkëpunim me OJQ qe meren me riintegrimin e personave të riadthesuar<br>Saradnja sa NVO koje se bave reintegarcijom repatriranih osoba | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | 33 | 2 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 3 | 4 | |
| | | Realizume<br>Realizovano | **25** | 1 | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 1 | 2 | 2 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal pë Riintegrim | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | Ucesce na Opstinskoj Komisiji za Reintegraciju | Realizume<br>Realizovano | **2** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | |
| 9 | Bashkëpunim me Zyren e Punesimit për projektet e personave të riadthesuar | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | Saradnja sa Zavodom za zapošljavanje na projektima repatriranih lica | Realizume<br>Realizovano | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| 10 | Takime me perfaqetsuesit e bashkësive lokale | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | Sastanci sa predstavnicima lokalnih zajednica | Realizume<br>Realizovano | **12** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| 11 | Vizita ne teren për të gjitha komunitetet për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre. | Nr.vizitave<br>Br.poseta | **27** | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | 2 | 3 | 2 | 2 | 2 | |
| | Terenske posjete svim zajednicama kako bi se dobile informacije o njihovim problemima i potrebama. | Realizume<br>Realizovano | **29** | 2 | 3 | 3 | 2 | 3 | 2 | 3 | 1 | 3 | 3 | 2 | 2 | |
| 12 | Bashkëpunim me Ministrit të ndryshme pran Qeverin Kosovës si dhe me Zyren e Kryeministrit | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **11** | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | Saradnja sa različitim Ministarstvima pri Vladi Kosova kao i Kancelarijom Premijera | Realizume<br>Realizovano | **10** | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| 13 | Pjesëmarja në Komitete të Formura | Nr.takimeve | **17** | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 0 | 1 | 2 | 1 | 2 | |
| | Učešće na formiranim komitetima | Realizume<br>Realizovano | **19** | 2 | 1 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 0 | 1 | 1 | 2 | 3 | |
| 14 | Bashkepunimi me Drejtorit Komunale | Nr.takimeve | **28** | 2 | 3 | 2 | 3 | 2 | 3 | 2 | 0 | 2 | 4 | 3 | 2 | |
| | Saradnja sa Opštinkim Direktoratima | Realizume<br>Realizovano | **27** | 1 | 2 | 3 | 2 | 3 | 3 | 2 | 0 | 2 | 4 | 2 | 3 | |
| 15 | Bashkëpunim me Qendren Për Punë Sociale | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **35** | 2 | 3 | 3 | 4 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 4 | 4 | |
| | Saradnja sa Centrom za socijalni rad | Realizume<br>Realizovano | **28** | 1 | 3 | 2 | 3 | 2 | 3 | 2 | 0 | 3 | 3 | 3 | 3 | |
| 16 | Bashkëpunim me Policin e Kosoves, FSK dhe KFOR | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **33** | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 3 | 3 | |
| | Saradnja sa Policijom Kosova, KBS i KFOR-om | Realizume<br>Realizovano | **33** | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 0 | 3 | 3 | 3 | 3 | |
| 17 | Bashkëpunim me ZKKK të Komunave tjera | Nr.takimeve<br>Br.sastanaka | **22** | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 0 | 2 | 2 | 2 | 2 | |
| | Saradnja sa OKZP drugih opština | Realizume<br>Realizovano | **5** | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | |

**Shefi I Zyres**

**Dipl.Ing.Sabahudin Ciriković**

# OPŠTINA PEĆ

GODIŠNJI IZVEŠTAJ 2024

**DIREKTORAT**

## OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

**SABAHUDIN CIRIKOVIĆ**

IME ŠEFA OPŠTINSKE KANCELARIJE ZA ZAJEDNICE I POVRATAK;

**GAZMEND MUHAXHERI**

IME PREDSEDNIKA OPŠTINE;

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Praćenje intraneta MUP-a i onlain sistema | Dnevni praćenje intraneta (elektronski sistem) | U periodu januar - decembar 2024. godine. Opštinska kancelarija za zajednice i povratak (OKZP) primila je 1 zahtev. |
| | Svakodnevno praćenje onlain sistema Ministarstva unutrašnjih poslova za repatrirana lica u 08:00 i 14:00 časova. | Sektor za reintegraciju i prava zajednica primio je 13 slučajeva repatrijacije putem online sistema. |
| | Ukupan broj repatriranih lica za 2024 | Za vremenski period januar - decembar za 2024. godinu, prema nacionalnoj pripadnosti :<br>Albanaca - 4 Individue<br>Egipćani - 3 individue i 1 porodica sa 9 članova<br>Rom - 3 Individue - 2 porodice sa ukupno 16 članova<br>Aškalije - 1 individua |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa Ministarstvom unutrašnjih poslova kao i sa regionalnim koordinatoroom MUP-a | Svakodnevna saradnja vezana za onlijn sistem, probleme ili slučajeve u vezi sa reintegracijom repatriranih lica. | Svakodnevna saradnja (konsultacije) sa regionalnim koordinatorom Arbenom Goranijem u vezi terenske verifikacije u roku od 5 dana repatriranih lica, prema uredbi br. 22/2020 o reintegraciji repatriranih lica i o upravljanju programom reintegracije |
| | Saradnja sa Ministarstvom unutrašnjih poslova - regionalni sektor za upravljanje predmetima | Saradnja sa Ministarstvom unutrašnjih poslova – regionalnim sektorom za upravljamje slučajevima, vezano za verifikaciju podataka repatriranih slučajeva kao i kompletiranje istih podataka u onlajn sistemu. |
| | Ministarstvo unutrašnjih poslova/Departman za reintegraciju raseljenih lica i integraciju stranaca, organizovalo je radionicu uz podršku GIZ - Nemačke organizacije za međunarodnu saradnju. | • "Unapređenje međuregionalne saradnje, jačanje kapaciteta lokalnih aktera za efikasno savetovanje i sprovođenje politika reintegracije.<br><br>• Procena potreba vezanih za proces reintegracije i integraciju repatrijanata", radionica je obuhvatila duboke sesije, diskusije i praktične vežbe, s ciljem podrške lokalnim akterima u uspešnom sprovođenju ovih politika.<br><br>• "Obuka za Informativnu Kružnicu o sprovođenju Pravilnika QRK NR. 22/2020 o reintegraciji repatrijanata." Implementacija opštinskih akcionih planova za reintegraciju repatrijanata i integraciju stranaca.<br><br>• Sprovođenje politika integracije stranaca i njihovog pristupa integracionim šemama." |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa Ministarstvom za zajednice i povratak (MZP) | Redovni sastanci sa MZP | Redovni sastanci sa MZP u vezi procesa povratka i održivih rješenja. |
| | Sastanak i saradnja vezana za online sistem | Obuka za korištenje nove baze podataka MZP-a, koja je u skladu sa Uredbom (QRK) - br. 01/2018 za povratak raseljenih lica i trajno naselje. |
| | Regionalni koordinacioni sastanak | Svrha sastanka je da okupi opštinske i centralne aktere koji rade na pitanjima povratka, da razgovaraju o procesu dobrovoljnog povratka i planovima za narednu 2024. godinu. |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa central nim nivoom | Ministarstvo za upravljanje lokalnom samoupravom (MAPL), u saradnji sa Organizacijom "Glas Roma, Aškalija i Egipćana", "Terre des hommes" i "HEKS", organizovalo je okrugli sto za diskusiju. | „Procena kapaciteta op[tinskih struktura zaduženih za rad sa marginalizovanim grupama/MAPL i „Pravilnik o (QRK) br. 15/2023 o postupku prijema u državnu službu". |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa Lokalnim nivoom | Saradnja sa drugim Opštinama - OKZP | Tokom godine posetili smo OKZP u opštinama Istok, Dečani, Klina, Đakovica i Prizren. Svrha ovih posjeta je bila razmjena iskustava, kao i razmjena informacija o radu kancelarije. |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa Kosovskom policijo, KBS i KFOR-om | Sastanci sa Policijom i KBS -om | Redovni mesečni sastanci za pitanja zajednica u opštini Peć. |
| | Sastanci sa KFOR-om | Sastanci sa KFOR-om o položaju zajednica u opštini Peć. |

| Oblast | Aktivnost | Rezultati |
|---|---|---|
| Saradnja sa nevladinim organizacijama | Saradnja sa IOM-om vezano za projekte RRK V | Za ovu godinu imali smo 4 nova slučaja zainteresovanih za povratak iz Crnu Goru. Ove godine nismo imali novih slučajeva povratka. Izgrađena je jedna kuća( stari slučaj ) iz ovog program u Gorazdovcu, srpska zajednica - 3 člana porodice. |
| | aradnja sa IOM-om u vezi sa projektom "Stabilizacija zajednica". | • Procena na terenu aplikanta za projekat.<br>• Primo predaja projekta Snabdevanje sa sredstvima za konkretizaciju/Laboratorija Fizike - Hemije - Biologije za osnovnu školu u Novom selu-Peć. |
| | Fondacija Jahjaga u koordinaciji sa Kancelarijom šefa Misije UNHCR-a u Prištini i Kancelarijom UNDCO-a organizovala je sastanak sa predstavnicima SO Peći i zajednicama povratnika u Peći. | „Investiranje u ekonomsko osnaživanje za poboljšanje blagostanja, socijalne uključenosti i održivosti među ženama i mladima koji se vraćaju“. Cilj je ispitivanje mogućih puteva za olakšavanje uključivanja ovih pojedinaca u mogućnosti socijalno-ekonomski razvoj. |
| | Agencija za regionalni razvoj - Zapad, organizovala je okrugli sto "Razvojni prioriteti OSHC-a iz Zapadnog regiona i buduća saradnja sa MRR", kao zajednički sastanak Ministarstva za regionalni razvoj sa Organizacijama civilnog društva iz zapadnog regiona Kosova. | Cilj okruglog stola sa organizacijama civilnog društva iz regiona je diskusija o mogućnostima saradnje sa Ministarstvom za regionalni razvoj (MRR) u ostvarivanju zajedničkih razvojnih ciljeva, mogućnostima finansiranja aktivnosti organizacija civilnog društva za svrhe uravnoteženog regionalnog razvoja, kao i pravnim implikacijama novog Zakona o regionalnom razvoju i povezanih podzakonskih akata, prema priloženoj agendi. |
| | Organizacija za bezbednost i saradnju u Evropi (OSCE) misija na Kosovu organizovala je radionice. | • „Evaluacija 'Dvodnevne radionice o sprečavanju nasilnog ekstremizma i radikalizacije koja vodi ka terorizmu (SENERT), u opštini Peć'. Radionica ima za cilj osnaživanje žena u sprečavanju i borbi protiv nasilnog ekstremizma i terorizma.<br>• 'Povećanje kapaciteta za unapređenje zapošljivosti vraćenih žena i žena iz manjinskih zajednica, kao korisnica socio-ekonomskih inicijativa iz regiona Peći i Mitrovice.'“ |
| | Projekti za decentralizaciju i podršku opštinama (DEMOS) | „Poboljšanje performansi opština u upravljanju, menadžmentu i uslugama doprinosi povećanju zadovoljstva građana.“ Jedna od važnih komponenti projekta odnosi se na angažovanje građana u procesu planiranja opštinskog budžeta. |

| Oblast | Aktivnost | Rrezulltati |
|---|---|---|
| Saradnja sa Opštinskim Direktoratima | •Učešće u Opštinskoj komisiji za reintegraciju (OKR)<br>• Opštinska Komisija za Povratak (OKP)<br>• Komitet za Zjednice (KZ)<br>• Komitet za Politiku i Finansije (KPF)<br>• Opštinsko Veće za Bezbednost Zajednice i (OVBZ)<br>• Skupština<br>• Komisija za procenu subvencija 2023 – Odeljenje za omladinu<br>* Opštinski komitet za koordinacion mehanizma protiv nasilja u porodici | • OKR održala je 2 sastanka na kojima je razmatrano 2 slučaja (Zahteva);<br>2 Zahteva za smeštaj<br>OKP je održao 1 sastanak i razmotren je 1 slučaj.<br>**<u>Nacionalnost</u>**<br>Egipćani - 1<br>Svi slučajevi su u online sistemu.<br>• OKZP je učestvovala na 11 redivnih sastanaka Komiteta za Zajednice (KZ)<br>•<br>OKZP je učestvovala na 2 redivna sastanaka Komiteta za Politiku i Finansije (KPF)<br>• Tokom ovog perioda, OKZP je učestvovao na 6 sastanaka na Opštinskom Veću zaBezbednost Zajednice (OVBZ). |

| Oblast | Aktiviteti | Rrezulltati |
| --- | --- | --- |
| Ostale usluge OKZP-a | Prijem stranaka | OKZP pruža savetodavne usluge stranaka na dnevnoj bazi u vezi sa povratkom, reintegracijom i pravima zajednica. |
| | "Poseta raseljenih u Crnoj Gori." | • Poseta "Idi i informiši " u Herceg Novom<br>•Poseta 4 slučajeva koji su izrazili interesovanje za povratak. |
| | OKZP vrši terenske posjete povratnicima, repatriranim licima i svim zajednicama, kako bi vidjeli njihovu reintegraciju u društvu i dobili informacije o njihovim problemima i potrebama. | Posete su obavljene na celoj teritoriji opštine Peć |
| | Finansije OKZP-ja | • Prema zahtevima iz budžeta Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak, svi zahtevi se razmatraju i ažuriraju na vreme.<br>• Učešće u sastavljanju-pripremi opštinskog budžeta (dio za OKZP-a u okviru KAB-a). |

| Emri Mbiemri | Emri | Mbiemri | Raporti i punës 2015 | Planifiki mi për 2016 |
|---|---|---|---|---|
| Fatmir Asllani | Fatmir | Asllani | ✓ | |
| Besim Avdimetaj | Besim | Avdimetaj | ✓ | |
| Jeton Abazaj | Jeton | Abazaj | ✓ | |
| Artan Gashi | Artan | Gashi | ✓ | |
| Salih Lajçi | Salih | Lajçi | ✓ | |
| Mustaf Nila | Mustaf | Nila | ✓ | |
| Petrit Loci | Petrit | Loci | ✗ | |
| Suzana Muriqi | Suzana | Muriqi | ✓ | |
| Engelbert Zefaj | Engelbert | Zefaj | ✓ | |
| Muhamet Mahmutaj | Muhamet | Mahmutaj | ✓ | |
| Edmond Shala | Edmond | Shala | ✓ | |
| Ukë Selimaj | Ukë | Selimaj | ✓ | |
| Mehdi Mulaj | Mehdi | Mulaj | ✓ | |
| Demë Dashi | Demë | Dashi | ✗ | |
| Sabahudin Cirikovic | Sabahudin | Cirikovic | ✓ | |

| Drejtoria | Shkurtes |
|---|---|
| Drejtoria e Administratës dhe Personelit | DAP |
| Drejtoria Komunale e Arsimit | DKA |
| Drejtoria për Buxhet dhe Financave | DBF |
| Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik | DZHE |
| Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit | DUMM |
| Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi | DKGJ |
| Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | DSHMS |
| Drejtoria për Integrime dhe Diasporë | DID |
| Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | DKRS |
| Drejtoria Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim | DKMSH |
| Drejtoria për Çështje Pronësorë Juridike | DSHPJ |
| Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike | DPKSHP |
| Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidro-Ekonomi | DBPH |
| Drejtoria për Inspekcion | DI |
| Zyra për Komunitet dhe Kthim | ZKK |

| EMAIL | Nr Kontaktues | Ngjyra |
| --- | --- | --- |
| fatmir.asllani@rks-gov.net | 049 429 000 | |
| besim.avdimetaj@rks-gov.net | 049 359 000 | |
| jeton.abazaj@rks-gov.net | 049 364 000 | |
| artan.gashi@rks-gov.net | 049 469 000 | |
| salih.lajci@rks-gov.net | 049 475 000 | |
| Mustafe.Nila@rks-gov.net | 049 489 000 | |
| petrit.loci@rks-gov.net | 049 112 333 | |
| suzana.muriqi@rks-gov.net | 049 479 000 | |
| engelbert.zefaj@rks-gov.net | 049 476 000 | |
| muhamet.mahmutaj@rks-gov.net | 049 486 000 | |
| edmond.shala@rks-gov.net | 049 451 000 | |
| uke.selimaj@rks-gov.net | 049 481 000 | |
| mehdi.mulaj@rks-gov.net | 049 436 000 | |
| deme.dashi@rks-gov.net | 049 471 000 | |
| sabahudin.cirikoviq@rks-gov.net | 049 142 765 | |

# RREGULLORE
# Nr.01/2025 (KPE)
# PËR
# SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME "MERIMANGË" NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PEJËS

**Mars, 2025**

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**Nr.Prot: 400-01/74424/2025**
**Data ... Prill 2025**

Në kuptim të dispozitave të nenit 17 paragrafi 1 shkronja f) dhe n) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (GZ e RK Nr.28, dt.04.qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, 7, 88,89 91,92 dhe 93 të Ligjit Nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugorë (GZ e RK Nr.6 dt.18 mars 2024), të dispozitave të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor (GZ e RK Nr.21 dt.13 qershor 2013) dhe dispozitave të nenit 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Nr.01-016/01-413431/2020 dt.30 shtator 2020, Kuvendi i Komunës se Pejës, pas kërkesës për rishqyrtimin e rregullores, nga MMPHI-së, nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025, në mbledhjen e mbajtur më datë ...Prill 2025, miratoi këtë:

# Draft - RREGULLORE Nr.01/2025 (KPE) PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME "MERIMANGË" PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË PEJËS

## I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Me këtë Rregullore, rregullohen kushtet dhe mënyra e zhvendosjes së automjeteve të ndaluara ose të parkuara në rrugë, apo në hapësira tjera të ndaluara, ku rrezikohet siguria në komunikacion ose pengohet rrjedha normale e komunikacionit dhe ushtrimi i shërbimit të transportit me "merimangë" në territorin e komunës së Pejës.

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Shërbimi i transportit me "merimangë", nënkupton tërheqjen/bartjen e automjeteve të marra nga vendet ku është i ndaluar parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim.

2.Pas konstatimit të shkeljes së rregullave në komunikacion, të evidencuar nga personat kompetent, se automjeti është ndaluar apo parkuar në mënyrë jo të rregullt, ai tërhiqet në bazë të

urdhëresës së zyrtarit policor ose ***kërkesës se personit të autorizuar nga organi i Komunës së Pejës.***

3.Para se të jepet urdhëresa për zhvendosjen e automjetit, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, pozita e automjetit të ndaluar ose parkuar në mënyrë jo të rregullt, dëshmohet me fotografi ose me skicë .

4.Vendin (lokacionin) për vendosjen e automjeteve në autopark, nga paragrafi paraprak, e cakton Komuna (Drejtoritë kompetente).

## Neni 3
## Zhvendosja dhe bllokimi

1.Tërheqja/bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë, të inspektorit komunal të komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.

2.Automjetet e ndaluara ose të parkuara në mënyrë jo të rregullt zhvendosen, ndërsa autobusët, automjetet transportuese, makinat dhe automjetet e punës dhe rimorkiot, bllokohen apo nëse është e mundshme tërhiqen në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organet e Administratës komunale: inspektori i komunikacionit apo inspektori komunal, në bashkëpunim me Policinë.

3.Operatori i transportit me "merimangë", do të caktohet përmes thirrjes të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me "merimangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

## Neni 4
## Lidhja e kontratës

1.Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit - fituesin e tenderit për transport me "merimangë", me të cilin do t'i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

2.Kontrata nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar deri në tri (3) vite, me mundësi vazhdimi.

## Neni 5
## Dokumenti i automjetit dhe dëshmia e pagesës

1.Në momentin e tërheqjes/marrjes së automjetit nga operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkojë edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën, se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar atë para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

2.Operatorit i lejohet lëshimi i automjetit, kur pronari ose drejtuesi i automjetit ofron dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bën pagesën e taksës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

## Neni 6
## Obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit

1.Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut të Komunës.

2.Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata e tërheqjes.

3.Operatori është përgjegjës në rast keqpërdorimi, dëmtimi eventual gjatë ngarkimit -shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autoparkun komunal (dëmin eventual të shkaktuar duhet t'ia kompensojë pronarit të automjetit).

4.Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në parkingun komunal, përgjegjësia bie mbi operatorin në rastin kur i njëjti operator e bënë sigurimin ose mbi personelin e sigurimit të autoparkut (në rast se sigurimi nuk bëhet nga ana e operatorit), deri të bëhet tërheqjen e automjetit nga pronari.

## Neni 7
## Kushtet për shërbimin e transportit me "merimangë"

1.Operatori i cili ushtron këtë veprimtari, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të jetë i regjistruar për ushtrimin e shërbimit të transportit me "merimangë",
1.2. Të ketë së pakut dy automjete për bartjen e automjeteve,
1.3. Të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,
1.4. Të sigurojë shërbimin 24-orësh, gjatë shtatë (7) ditëve të javës,
1.5. Të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë (për një automjet për bartje të ketë ngasësin dhe ndihmësin).

## Neni 8
## Kushtet për automjetet bartëse

1.Automjetet duhet:

1.1 Të jenë të regjistruara,
1.2 Të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve, (njëri automjet duhet të jetë me vinç, të ketë katër mengenetë, të cilat duhet të vendosen në rrota të automjetit, kurse tjetri duhet të jetë me litar tërheqës ( metalik), që ta bëjë ngarkimin e veturave),
1.3 Është e preferuar të kenë ngjyrë të njëjtë,
1.4 Në çdo kohë, të jenë në gjendje teknike të rregullt,
1.5 Ti kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,
1.6 Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe
1.7 Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

## Neni 9
## Kushtet për drejtuesit e automjeteve

1.Drejtuesit e automjeteve duhet:

1.1. Të jenë në marrëdhënie pune të operatori,
1.2. Të kenë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës,
1.3. Të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes.

**Neni 10**
**Tarifa e shpenzimeve**

***Vendosja e çmimores/shpenzimeve për zhvendosjen se mjeteve caktohet me aktë nënligjorë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në bashkëpunim me Policinë.***

**Neni 11**
**Puna me bllokues**

**1.** Sipas kësaj Rregulloreje, operatori duhet të jetë i pajisur me bllokues.

**2.**Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, në marrëveshje me policinë, në çdo kohë dhe në çdo vend.

**3.** Automjetit të cilit i vendosen bllokuesit, duhet të paguajë gjobën sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

**Neni 12**
**Lirimi nga tarifa e pagesave**

1.Nga pagesa lirohen:

**1.1.** Automjetet e zhvendosura ose automjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e Policisë, me qëllim të verifikimit të dokumentacionit dhe të automjetit, në rast se verifikimi rezulton i rregullt;
**1.2.** Automjetet e zhvendosura ose që tërhiqen, në rastet kur automjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në automjet dhe
**1.3.**Automjetet e tërhequra nga Policia për shkaqe sigurie.

**2.** Si dëshmi e plotësimit të këtyre kritereve të paragrafit paraprak, Policia, gjatë plotësimit të raportit, duhet shënuar arsyen e tërheqjes/marrjes së automjetit.

**Neni 13**

Në rast të shkeljes së ndonjërës nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike mban të drejtën e shkëputjes së kontratës me operatorin ekonomik.

**Neni 14**
**Afati për tërheqjen e mjetit të zhvendosur**

Në qoftë së mjeti i zhvendosur nuk kërkohet nga pronari brenda gjashtë (6) muajsh, mjeti do të shitet me ankand publik dhe të hollat shkojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, përveç mjeteve që janë në proces të hetimeve penale.

## II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 15

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.08/L–186 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

### Neni 17
### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqën e Komunës së Pejës.

______________________________

**Rexhep Kurtbogaj**
**Kryesues i Kuvendit të Komunës**
**Komuna e Pejës**

1.Kryetari i Komunës propozon që të zhvilohen procedurat e nevojshme ligjore për Këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, ku objekt i Këmbimit në mes të Komunës dhe pronarëve privat janë ngastra kadastrale nr.203-3 në sipërfaqe prej 5039$m^2$ ZK Ramun me pronar Leutrim ( Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë ( Bajram) Muzlijaj me ¾ e cila është propozuar për ngastrat kadastrale nr. 33-4 në sipërfaqe prej 25$m^2$ ZK Llabjan me pronar P.SH Rrugët , nr.246-4 në sipërfaqe prej 67$m^2$ ZK Zahaq PRONË SHOQËRORE RRUGËT,nr.118-9 me sipërfaqe prej 148$m^2$ ZK Zahaq PRONË SHOQËRORE E FSHATIT ZAHAQ DHE NR. 3-31 me sipërfaqe prej 127900$m^2$ ZK Leshan pronë **Komuna e Pejës**, për Interes Publik: "Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun".

2.Kryetari i Komunës propozon që të zhvilohen procedurat e nevojshme ligjore për Këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, ku objekt i Këmbimit janë ngastrat kadastrale: nr.2308-0 me sipërfaqe prej 263$m^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, nr.2309-0 me sipërfaqe prej 166$m^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe nr.2310-0 me sipërfaqe prej 163$m^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, të cilat janë propozuar për ngastrat kadastrale nr.5330-10 me sipërfaqe prej 1231$m^2$ ZK Pejë dhe nr.5755-88 me sipërfaqe prej 4485$m^2$ ZK Pejë që të dyja me pronar **Komuna e Pejës**, për Interes Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit në këto ngastra.

3.Kryetari i Komunës propozon që të zhvilohen procedurat e nevojshme ligjore për Këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, ku objekt i Këmbimit është njësia kadastrale nr: **O-71611071-01252-1-404-1-1-0** ZK Pejë në pronësi të Kimete (Adem) Hasaj (banesë) e cila është propozuar për ngastren kadastrale nr.131-3 me sipërfaqe prej 4150$m^2$ ZK Zagërm me pronar **Komuna e Pejës.**, për Interes Publik: " Ndërtimi i Qendrës Kryesore Fmiljare"

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 04 — Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 1944
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: 2+94 — Data / Datum / Date: 25.02.25
PRISHTINË / A — No.2

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Departamenti Ligjor / Pravnim Departmanom / Legal Department 15 - DL

| | | |
|---|---|---|
| Për: | z. Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br>z. Jeton Qela, u.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së | |
| Kopje: | z. Gazmend Muhaxhiri, Kryetar i Komunës Pejës<br>z. Erblin Hetemi, Drejtor i DL në MAPL-së | |
| Përmes: | z. Hysen Durmishi, Zëvendësministër i MMPHI-së<br>z. Izedin Bytyqi, u. D i Sekretarit të Përgjithshëm MMPHI-së | |
| Nga: | Florije Boshnjaku, Drejtore e Departamentit Ligjor | |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>Zyrtare raportues i vlerësimit ligjor | <br><br>Vlora Hasanramaj, u.d Udhëhqëses së Divizionit të Mbikqyrejes dhe Zbatimit të Legjislacionit | Datë: 19.02.2025 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së Rregullores nr. 01/2025 për Shërbimin e Transportit me "Merimangë", për Territorin e Komunës së Pejës | |
| Lloji i aktit: | Rregullorja nr. 01/2025 për Shërbimin e Transportit me "Merimangë", për Territorin e Komunës së Pejës | |

Të nderuar

Në mbështetje të Ligjit nr.08/L -284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike si dhe shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) nr.14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

Departamenti Ligjor i Ministrisisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësionr me datën 06.02.2025, ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkesën nr.0-68/1 për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës:

- Rregullores nr. 01/2025 për Shërbimin e Transportit me "Merimangë" për Territorin e Komunës së Pejës, të miratuar nga Kuvendi Komunes së Pejës me datën 31 janar 2025.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Rregullores Nr. 01/2025 dhe pas konsultimit me z. Habib Hasani zyrtar në Departamentin e Patentë Shoferit dhe Automjeteve vlerëson se akti i lartëcekur nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut

**Mos pajtueshmëria e Rregullores 01/2025 e parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë është si vijon:**

| Nr. | *Formulimi në aktin e komunës* | *Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.* |
|---|---|---|
| 1. | Neni 10 | Dispozita e këtij neni nuk është në pajtim me dispoziten e nenit 93 paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor |
| 2. | Neni 11 paragrafi 3 rrjedh nga neni 10 Rregullorës në fjalë | Paragrafi 3 i këtij neni nuk është në pajtim me dispoziten e nenit 93 paragrafi 3 të Ligjit nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor |
| 3. | Neni 14 | Dispozita e këtij neni nuk është në pajtim me dispoziten e nenit 92 paragrafi 1 Nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor |
| 4. | Neni 3 paragrafi 3 | Paragrafi 3 i këtij neni të harmonizohet me nenin 91 paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i propozon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës, për rishqyrtim të aktit.

MMPHI mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-128/3
-VI- Data. Datum. Date. 24.03.2025

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Gazmend Muhaxheri**, Kryetar i Komunës së Pejës<br>**Rexhep Kurtbogaj**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Jeton Qela** , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | **Erblin Hetemi**,Drejtor i Departamentit Ligjor | Datë:<br>21.03.2025<br>VI-020-128 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**,Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Leonora Bajrami**, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Pejës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/I-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave , Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Nr.03/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllave për panela solare-me negocim nga kryetari i komunës |
| I miratuar më datë: 28.02.2025 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.03.2025 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2025, ka miratuar Vendimin Nr.03/2025 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllave për panela solare-me negocim nga kryetari i komunës i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës.

MAPL, konstaton se Ligji Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nuk parasheh miratimin e Vendimit paraprak për dhënien ne shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme komunale me negocim nga kryetari i komunës.

Po ashtu baza ligjore e vendimit duhet të bazohet në nenin 11 të Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku sqarohet procedurat e dhënies së pronës komunale ne shfrytëzim me negocim nga kryetari i komunës.

Kryetari i Komunës ka të drejtë pa zhvilluar procedurat paraprake **(pa marr vendim paraprak në Kuvend të Komunës)** të negocioj ofertat e paraqitura nga palët e interesuara dhe të paraqet propozimin final për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Pejës, duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-128/3
-VI- Data. Datum. Date. 24.03.2025

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Gazmend Muhaxheri,** gradonačelnik opštine Peć<br>**Rexhep Kurtbogaj,** predsedavjući Skupštine opštine Peć | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Elbert Krasniqi, ministar MALS-a,<br>Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a, | |
| Od: | Erblin Hetemi, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS | Datuma:<br>21.03.2025<br>VI-020-128 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik za potvrđivanje pravne procene:<br>2. Službenik za izradu pravne ocene | Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština<br>**Leonora Bajrami**, službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za ponovno razmatranje | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine Peć | |

Poštovani/a gradonačelniče,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 03/2024 o prethodnom odobrenju davanja na korišćenje nepokretnosti opštine u KZ Lutogllave za solarne panele - uz pregovore sa gradonačelnikom |
| Usvojena dana, 28.02.2025.god |
| Predložena na razmatranje u MALS dana, 03.01.2025.god |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja opštinskog akta kao u prethodnom tekstu, procenjuje da opštinski akt, ***nije u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.***

Obrazloženje

Skupština opštine Peć je na održanoj sednici dana, 28.02.2025.godine, odobrila Odluku br. 03/2024 o prethodnom odobrenju davanja na korišćenje nepokretnosti opštine u KZ LutogIlave za solarne panele - uz pregovore sa gradonačelnikom, donetu od strane Skupštine opštine Peć.

MALS konstatuje da, Zakon br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne opštinske imovine ne predviđa usvajanje Predhodne odluke o davanju na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine pregovorima sa gradonačelnikom.

Takođe, pravni osnov odluke treba da se zasniva na članu 11. Zakona 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine i članu 23 Uredbe (VRK) br . 09/2020 o utvrđivanju postupaka danja na korišćenje i razmeni nepokretne opštinske imovine, koji pojašnjava postupke za davanje opštinske imovine na korišćenje putem pregovora gradonačelnika opštine.

Gradonačelnik ima pravo, bez sprovođenja prethodnih postupaka (**bez donošenja prethodne odluke u Skupštini opštine**), da pregovara o ponudama zainteresovanih lica i da konačan predlog za davanje na korišćenje nepokretnosti opštine iznese na konačno odobrenje u Skupštini opštine.

Stoga, na osnovu gore navedenog, Skupština opštine Peć, treba preduzeti mere i u zakonskom roku od 30 dana preispitati i uskladiti akt sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

HYRËSE - ULAZNA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Data: 03.03.2025
Njësia organizative: -41- Nr. i Lëndës: 020-128

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**I.Numër: 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025**

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 11 dhe nenit 21 pika 1, paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenit 4, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe 14 23 dhe 25 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431,dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propzimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – *ZK Lutogllavë për Panela Solare,* me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 28 Shkurt 2025, merr këtë:

**VENDIM**
**Nr. 03/2025**
**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës**

I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare, në afat prej tridhjetë (30) viteve sipas Vendimit Nr. 61-2024 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025, me nr. Prot. 400/01-87552, dt. 29 Tetor 2024.

| *Nr.* | *PRONARI Poseduesi* | *Nr. i Ngastrës* | *Emri i rrugës (lokacioni)* | *Sipërfaqja* | *Zona Kadastrale* | *Destinimi* | *Periudha* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | KK Pejë | 00167-6 | Fsh. Lutugllavë | 112258 $m^2$ | ZK Lutugllavë | Panela Solare | 30 vite |

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore Kuvendi i Komunës e autorizon Kryetari i Komunës për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme sipas legjislacionit vendor në fuqi për negocimit me LIMAK. LIMAK është një shoqëri e inkorporuar sipas ligjeve të Turqisë, me seli në Hafta Sokak, Ankara/Turqi, për zhvillimin dhe operimin e një projekti diellor prej 8 MW ("Projekti" ose "SPP") brenda territorit të Komunës së Pejës, ndërsa komuna është e gatshme të organizojë procedurën e negociuar për dhënien e pronës komunale me qira afatgjatë të qirasë për zhvillimin e Projektit të Centralit Diellor.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**Rexhep Kurtbogaj**

*Vendimi ti dërgohet:*
*MAPL-së,*
*Kryetarit të Komunës,*
*DÇPJ,*
*Arkiv.*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

HYRËSE - ULAZNI - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS | REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS | VLADA KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data. 03.03.2025
Datum.
Date.
Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Vlera
-01- | 024-128 |

**SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ**
**I.br: 463/01-10508, dana 28. Februara 2025.**

Na osnovu odredbi članova 11,12, stav 2 tačka d) i člana 14 stav 1 Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosovo od 20. Februara 2008. godine i članova 5,6,8 i 14 i člana 21 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni opštinskih imovina, člana 4, člana 5 stav 1.3, člana 6, člana 13 i 14, 23 i 25 Pravilnika VRK br.09/2020 o određivanju postupka davanja nekretnina Opštine na korišćenje, kao i člana 20 stav 1 tačka 1.4 Statuta br.01/2020 Opštine Peć I. broj:01-16/01-413431 od 30. Septembra 2020, posle razmatranja predloga Gradonačelnika za načelno usvajanje davanja opštinskih nekretnina-KZ Ljutoglava, za solarne panele, po preporuci Komiteta za Politiku i Finansije, Skupština Opštine Peć je na sednici održanoj dana 28. Februara 2025.godine donela ovu:

**ODLUKU**
**Br. 03/2025**
**O načelnom usvajanju davanja opštinske nekretnine na dugoročno korišćenje – KZ Ljutoglava za solarne panele- u dogovoru sa Gradonačelnikom Opštine**

I. **Usvaja se** predlog Gradonačelnika Opštine za načelno usvajanje davanja opštinskih nekretnina na dugoročno korišćenje-KZ Ljutoglava za solarne panele, na period od 30 godina prema odluci broj 61-2024 o usvajanju posebne liste opštinskih imovina koje će biti date na korišćenje tokom 2025. Godine, sa brojem protokola 400/01-87552 od 29.oktobra 2024.godine.

| *Br.* | *VLASNIK Posednik* | *Broj parcele* | *Naziv ulice (lokacija)* | *Površina* | *Katastarska zona* | *Namena* | *Period* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | SO Peć | 00167-6 | Selo Ljutoglava | 112258 $m^2$ | ZK Lutugllavë | Solarni paneli | 30 godina |

II. Posle ispunjavanja zakonskih uslova, ovlašćuje se Gradonačelnik Opštine za odvijanje daljeg postupka prema zakoniodavstvu na snazi za pregovaranje sa LIMAK-om. LIMAK je je udruženje osnovano prema zakonima Turske, sa sedištem u Hafta Sokak, Ankara, Turska, za odvijanje sunčanog projekta od 8 MW (projekat ili SPP) na teritoriji Opštine Peć, a Opština je spremna da organizuje postupah pregovaranja za davanje optinskih nekretnina na dugoročni zakup za ostvarivanje projekta sunčane centrale.

III. Za primenu ove odluke i zakonskih odredbi o davanju na korišćenje i razmeni nekretnina Opštine zadužen je Gradonačelnik Opštine i Direktorat za Pravno-Imovinska Pitanja.

IV. Ova odluka biće objavljena 30 dana posle registrovanja u Kancelariji za Protokolisanje u MALV-u, i stupa na snagu 7 dana posle objavljivanja na web stranici Opštine Peć.

**PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**
**G. Rexhep Kurtbogaj**

**Odluka se dostavlja:**
MALV-u,
Gradonačelniku Opštine,
DPIP-u,
Arhivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

1. Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 nenit 20 dhe neni 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 11.02.2025 pas shqyrtimit të rekomandimit të Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike për dhënien në shfrytëzim, të parcelës 00167-6, prone komunale, fshati Lutogllavë më siperfaqe 112258m2, ZK Lutogllavë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 30 vite, merr këtë:

**K o n k l u z i o n**

2. **I propozohet** Komitetit Për Politikë dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale ne Pejë kërkesën e Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike për dhënien ne shfrytëzim të parcelës 00167-6, prone komunale, fshati Lutogllavë me siperfaqe 112258m2, ZK Lutogllavë, poashtu e paraparë të ipet në shfrytëzim për 30 vite.

3. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Komitetit Për Politik dhe Financa,
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr. ~~400/01~~- 463/01-10608 / 2025**
**Pejë, 11 shkurt 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**I.Numër: dt. Shkurt 2025**

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 11 dhe nenit 21 pika 1, paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenit 4, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe 14 23 dhe 25 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propzimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – *ZK Lutogllavë për Panela Solare,* me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. ... Shkurt 2025, merr këtë:

**Draft - VENDIM**
**Nr. 03/2025**

**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës**

I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare, në afat prej tridhjetë (30) viteve sipas Vendimit Nr. 61-2024 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025, me nr. Prot. 400/01-87552, dt. 29 Tetor 2024.

| *Nr.* | *PRONARI Poseduesi* | *Nr. i Ngastrës* | *Emri i rrugës (lokacioni)* | *Sipërfaqja* | *Zona Kadastrale* | *Destinimi* | *Periudha* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | KK Pejë | 00167-6 | Fsh. Lutugllavë | 112258 $m^2$ | ZK Lutugllavë | Panela Solare | 30 vite |

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore Kuvendi i Komunës e autorizon Kryetari i Komunës për negocimit me LIMAK një shoqëri e inkorporuar sipas ligjeve të Turqisë, me seli në Hafta Sokak, Ankara/Turqi, për zhvillimin dhe operimin e një projekti diellor prej 8 MW ("Projekti" ose "SPP") brenda territorit të Komunës së Pejës, ndërsa komuna është e gatshme të organizojë procedurën e negociuar për dhënien e pronës komunale me qira afatgjatë të qirasë për zhvillimin e Projektit të Centralit Diellor.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

IV. Kjo Rregullore shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**Rexhep Kurtbogaj**

______________________

**Vendimi ti dërgohet:**
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611058-00167-6

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 01-414 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 18.10.2024 - 13:31 |
| Komuna / Opština / Municipality: | PEJË / PEČ / PEJË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Lutogllavë / Ljutoglava / Lutogllavë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | PEJË / PEČ / PEJË |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71611058-00167-6 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 112258 | 1-1998 | | |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KUÇANSKA MALA | | | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Dardan Brlajolli | P-71611058-00167-6 |

Zyrtari pergjegjes / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sip[illegible]<br>P[illegible] (m[illegible]<br>Are[illegible] |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klase/5th Class Arable Land | 112258 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **P.SH.K.K.PEJË QIRAMBAJTJA PER 99 VITE** | KCID1618242 | LUTOGLLAVË /<br>LJUTOGLAVA /<br>LUTOGLLAVË / | | | **1/1** | I/2015 | 06.02.2015 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lutogllavë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71611058-00167-6 | Parcelë / Parcela / Parcel | 112258 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:4582

Punoi/Obradio/Created: Dardan Bajolli

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 18.10.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:32:28

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**Numër: 400/01-87552, dt. 29 Tetor 2024.**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 2 pika d, neni 14, neni 58 shkronja a) b) d) g) i) të ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenit 5, 6, 8 dhe 13 të Ligjit nr. 06/L-092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajshme të Komunës, nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 7, paragrafi 1, pika 1.2 , dhe nenit 76, pararafi 1, të Statutit nr.01/2020, të Komunës së Pejës, I. numër: 01-16/01-413431 datë 30 Shtator 2020, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në takimin e mbajtur me datë: 29 Tetor 2024, merr këtë:

**VENDIM**
**Nr. 61/2024**
**mbi miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025.**

I. **Miratohet** - Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e veçante e pronave komunale që parashikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit vijues 2025, bazuar në Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

## Lista e veçantë e pronave të paluajtshme komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025.

| Nr. | PRONARI Poseduesi | Nr. i Ngastres | Emri i rrugës | Sipërfaqja | Zona Kadastrale | Destinimi | Përiudha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | KK Pejë | 2816-1 | Rr. Mbreti Piro | 2082 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 2. | KK Pejë | 02834-0 | Rr.Tony Bler | 102 $m^2$ | Pejë | Dhënie në Shfrytezim afat gjatë të pronës se paluajtshme | 99 vite |
| 3. | KK Pejë | 00282-5 | Rr.Adem Jashari | 1768 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 4. | KK Pejë | 03401-0 | Rr.Tony Bler | 6194 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 5. | KK Pejë | 01093-1 | Rr.Mbretëresha Teutë | 5703 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | KK Pejë | 05774-0 | Rr.Nëna Terezë-Të Arkivi | 2768 m2 | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 7. | KK Pejë | 01089-1 | Rr.Medeline Olbright-Te QKMF | 1271 m2 | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 8. | KK Pejë | 00167-6 | Fsh. Lutugllavë | 112258 m2 | ZK Lutugllavë | Panela Solare | 35 vite |

III. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioje procedurën e ankandit publik për zgjedhjen e ofertës me të favorshme për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave të parapara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

V. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**z. Rexhep Kurtbogaj**

**Vendimi ti dërgohet:**
1x1 MAPL-së,
1x1 Kryetarit të Komunës,
1x1 DÇPJ,
1x1 Arkivë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
VI-020-652/5
12.11.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Gazmend Muhaxheri**, Kryetar i Komunës së Pejës<br>**Rexhep Kutbogaj**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Jeton Qela** , Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së | |
| Nga: | **Erblin Hetemi**, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë:<br>05.11.2024<br>VI-020-652 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa,Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Pejës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Nr.61/2024 mbi miratimin e listës se veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjate vitit 2025 |
| I miratuar më datë: 29.10.2024 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.10.2024 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>.

**Leonora Bajrami**

---

**From:** Avni Gashi
**Sent:** Tuesday, March 18, 2025 11:25 AM
**To:** Leonora Bajrami; Xhevat Tafa
**Cc:** Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi
**Subject:** FW: Kerkese per informata

Pershendetje, e nderuara znj. Bajrami, si me poshte te forwarduar i gjeni informatat shtese nga znj. Syzana, zyrtare ne DÇPJ, te keruara nga ana juaj per vendimin Nr.03/2025, vendim i datës 28.02.2025, parcela P-71611058-00167-6 P.SH.K.K.Pejë Qirambajtje per 99 vite, kjo parcele a është në pronësi të komunës së Pejës?

*Përshëndetje,*

*Në lidhje me pyetjen tuaj se, a është parcela me nr. P-71611058-00167-6 ZK Lutogllavë P.SH.K.K. Pejë Qirambajtje për 99 vite në pronësi të komunës së Pejës?*

*Ju njoftojmë se e njejta është në pronësi të Pejës.*

*Me respekt,*
*Syzana*

---

**From:** Syzana Hajdari
**Sent:** Tuesday, March 18, 2025 11:18 AM
**To:** Avni Gashi; Luan Gashi; Albion Kelmendi
**Cc:** Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi
**Subject:** Re: Kerkese per informata

Përshëndetje,

Në lidhje me pyetjen tuaj se, a është parcela me nr. P-71611058-00167-6 ZK Lutogllavë P.SH.K.K. Pejë Qirambajtje për 99 vite në pronësi të komunës së Pejës?

Ju njoftojmë se e njejta është në pronësi të Pejës.

Me respekt,
Syzana

---

**From:** Avni Gashi
**Sent:** Tuesday, March 18, 2025 10:09:58 AM
**To:** Luan Gashi; Albion Kelmendi; Syzana Hajdari
**Cc:** Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi
**Subject:** FW: Kerkese per informata

Pershendetje, ju lutem referojuni emailit si me poshte per informata shtese, per vendimin Nr.03/2025, vendim i datës 28.02.2025, parcela P-71611058-00167-6 P.SH.K.K.Pejë Qirambajtje per 99 vite, kjo parcele a është në pronësi të komunës së Pejës?

Gjithashtu po ju bashkangjes kete vendim per ta ditur se per cka po behete fjale.

---

**From:** Leonora Bajrami
**Sent:** Tuesday, March 18, 2025 10:06 AM
**To:** Avni Gashi
**Cc:** Xhevat Tafa
**Subject:** Kerkese per informata

Përshëndetje,

Po ju shkruaj lidhur me vendimin Nr.03/2025, vendim i datës 28.02.2025, parcela P-71611058-00167-6 P.SH.K.K.Pejë Qirambajtje per 99 vite, kjo parcele a është në pronësi të komunës së Pejës.


Republika e Kosovës

**Me respekt,**

**Leonora Bajrami**
**Zyrtare për Monitorim të Komunave**
**Qerveria e Republikës së Kosovës**
**Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal**
**Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave**

PHONE MOBILE EMAIL
**+383 49 500 312** **leonora.bajrami@rks-gov.net**
Adresa: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë ' Ish Rilindja ' Kati 11/1117

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PREDSEDNIKA

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 19.03.2025, merr këtë:

## K o n k l u z i o n

**I propozohet** Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim dhe aprovim që i nijeti material të dërgohet në Kuvend Komunal në Pejë miratim të kërkesës së Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike për këmbimin e pronave në mes të Komunës se Pejës dhe pronarëve privat janë ngastra kadastrale nr.203-3 në sipërfaqe prej 5039m$^2$ ZK Ramun me pronar Leutrim ( Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë ( Bajram) Muzlijaj me ¾ e cila është propozuar për ngastrat kadastrale nr. 33-4 në sipërfaqe prej 25m$^2$ ZK Llabjan me pronar P.SH Rrugët , nr.246-4 në sipërfaqe prej 67m$^2$ ZK Zahaq PRONË SHOQËRORE RRUGËT,nr.118-9 me sipërfaqe prej 148m$^2$ ZK Zahaq PRONË SHOQËRORE E FSHATIT ZAHAQ DHE NR. 3-31 me sipërfaqe prej 127900m$^2$ ZK Leshan pronë **Komuna e Pejës**, për Interes Publik: "Krijimi i Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun".

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike të KK Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Kuvendit Komunal,
- Komitetit për Politik dhe Financa dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 400/01-13475 **/ 2025**
**Pejë, 19 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 19.03.2025, merr këtë:

## K o n k l u z i o n

**I propozohet** Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim dhe aprovim që i nijeti material të dërgohet në Kuvend Komunal në Pejë miratim të kërkesës së Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, ku objekt i Këmbimit janë ngastrat kadastrale: nr.2308-0 me sipërfaqe prej 263m$^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Anxha (Radosav) Ivanoviq dhe Radosav (Bogdan) Ivanoviq, nr.2309-0 me sipërfaqe prej 166m$^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini dhe nr.2310-0 me sipërfaqe prej 163m$^2$ ZK Pejë me shtëpi në pronësi të Zeqir (Beqir) Ajdini, të cilat janë propozuar për ngastrat kadastrale nr.5330-10 me sipërfaqe prej 1231m$^2$ ZK Pejë dhe nr.5755-88 me sipërfaqe prej 4485m$^2$ ZK Pejë që të dyja me pronar **Komuna e Pejës**, për Interes Publik: Rregullimin e sipërfaqes publike buzë lumit Lumbardh dhe shtratin e Lumit në këto ngastra.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike të KK Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Kuvendit Komunal,
- Komitetit për Politik dhe Financa dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 40061-19473 **/2025**
**Pejë, 19 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 19.03.2025, merr këtë:

# K o n k l u z i o n

**I propozohet** Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim dhe aprovim që i nijeti material të dërgohet në Kuvend Komunal në Pejë miratim të kërkesës së Drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës, ku objekt i Këmbimit është njësia kadastrale nr: **O-71611071-01252-1-404-1-1-0** ZK Pejë në pronësi të Kimete (Adem) Hasaj (banesë) e cila është propozuar për ngastren kadastrale nr.131-3 me sipërfaqe prej 4150m$^2$ ZK Zagërm me pronar **Komuna e Pejës**., për Interes Publik: " Ndërtimi i Qendrës Kryesore Fmiljare."

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike të KK Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Kuvendit Komunal,
- Komitetit për Politik dhe Financa dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 400/01-19468 **/ 2025**
**Pejë, 19 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 28.03.2025, merr këtë,

## K o n k l u z i o n

1. **I propozohet** Komitetit Për politik dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale kërkesën e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e Vendimit Nr. 03/2025 me nr. protokolli 463/01-10508, dt. 28 Shkurt 2025 K.K. Pejë, mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-128/3 të dt. 24.03.2025.

2. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset drejtorati për Çështje Pronësore Juridike.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Komitetit Për Politik dhe Financa
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 400/01-21485 **2024**
**Pejë, 28 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

1. Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe nenit 20 dhe 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 28.03.2025, merr këtë:

# K o n k l u z i o n

2. **I propozohet** Komitetit Për politik dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale në Pejë propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale, ZK Lutogllavë për Panela Solare – me negocim nga Kryetari i Komunës.

3. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset drejtorati për Çështje Pronësore Juridike.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Komitetit Për Politik dhe Financa,
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 400/01-2/480 **/ 2025**
**Pejë, 28 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

1. Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe nenit 20 dhe 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 28.03.2025, merr këtë:

## K o n k l u z i o n

2. **I propozohet** Komitetit Për politik dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale ne Pejë kërkesën e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së - sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit nga MAPL, me Nr. 020-8/16 të dt. 25.03.2025.

3. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset drejtorati për Çështje Pronësore Juridike.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Komitetit Për Politik dhe Financa,
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr. 400/01-21484 / 2025**
**Pejë, 28 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 28.03.2025, merr këtë,

## K o n k l u z i o n

1. **I propozohet** Komitetit Për politik dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale kërkesën e Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik, për Rishqyrtimin dhe miratimin e Rregullore Nr.01-2025 (KPE) për Shërbimin e Transportit me Merimangë në territorin e Komunës së Pejës, të dt. 31.01.2025, në kërkesës së MMPHI-së nr. Nr. 04-1944, dt: 25.02.2025.

2. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Zhvillim Ekonomik.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik,
- Komitetit Për Politik dhe Financa,
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**L.nr.** 400/01-21483 **2024**
**Pejë, 28 mars 2025**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetari i Komunës**

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-8/16
Data. Datum. Date. 25.03.2025

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Gazmend Muhaxheri**, Kryetar i Komunës së Pejës<br>**Rexhep Kurtbogaj**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Jeton Qela** , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | **Erblin Hetemi**,Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë:<br>24.01.2025<br>VI-020-8 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**,Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Leonora Bajrami**, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Pejës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Nr.76/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale- ish Zyret e QPS-së |
| I miratuar më datë: 30.12.2024 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.01.2025 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2024, ka miratuar Vendimin Nr.76/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale- ish Zyret e QPS-së i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës është në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

*Baza ligjore e vendimit neni 5 paragrafi 1.3 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës sqaron se: dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës, që nënkupton periudhën më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, ndërsa neni 2 i vendimit Nr.76/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale- ish Zyret e QPS-së, flet për ankandin publik e qe kjo procedurë është për dhënie ne shfrytëzim afatshkurtër.*

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Pejës, duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-8/16
-VI- Data. Datum. Date. 25.03.2025

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Gazmend Muhaxheri**, gradonačelnik opštine Peć<br>**Rexhep Kurtbogaj,** predsedavjući Skupštine opštine Peć | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Elbert Krasniqi, ministar MALS-a,<br>Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a, | |
| Od: | Erblin Hetemi, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS | Datuma:<br>24.01.2025<br>VI-020-8 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik za potvrđivanje pravne procene:<br>2. Službenik za izradu pravne ocene | Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština<br>**Leonora Bajrami**, službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za ponovno razmatranje | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine Peć | |

Poštovani/a gradonačelniče,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 76/2024 o prethodnom odobrenju davanja na korišćenje nepokretnosti opštine – bivših kancelarija CSR |
| Usvojena dana, 30.12.2024.god |
| Predložena na razmatranje u MALS dana, 03.01.2025.god |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja opštinskog akta kao u prethodnom tekstu, procenjuje da opštinski akt, ***nije u skladu sa odredbama***

Obrazloženje

Skupština opštine Peć je na održanoj sednici dana, 30.12.2024.godine, odobrila Odluku br. 76/2024 o prethodnom odobrenju davanja na korišćenje nepokretnosti opštine – bivših kancelarija CSR, donetu od strane Skupštine opštine Peć.

MALS konstatuje da je, Odluka doneta od strane Skupštine opštine Peć u suprotnosti sa Uredbom (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretnosti opštine.

*Pravni osnov odluke: član 5. stav 1.3 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupka za davanje na korišćenje i razmeni nepokretnosti opštine pojašnjava da: davanje na dugoročno korišćenje nepokretnosti opštine, što podrazumeva period duži od petnaest (15) godina do devedeset- devet (99) godina, dok član 2 Odluke br. 76/2024 o o prethodnom odobrenju davanja na korišćenje nepokretnosti opštine – bivših kancelarija CSR, govori o javnoj licitaciji i da je ovaj postupak za davanje na kratkoročno korišćenje.*

Stoga, na osnovu gore navedenog, Skupština opštine Peč, treba preduzeti mere i u zakonskom roku od 30 dana preispitati i uskladiti akt sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

HYRËSE - ULAZ - INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 03.01.2025
-01- 020-8

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**I.Numër: 463/01-98164, dt. 30 Dhjetor 2024.**

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenit 4, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe 14 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propzimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – *ish Zyret e QPS-së*, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 30 Dhjetor 2024, merr këtë:

**VENDIM**
**Nr. 76/2024**

**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së**

**I. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së, në afat prej tridhjetë e pesë (35) viteve sipas Vendimit Nr. 71-2023 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024, me nr. Prot. 463-01/117215, dt. 28 Dhjetor 2023.

| *Nr.* | *PRONARI Poseduesi* | *Nr. i Ngastres* | *Emri i rrugës (lokacioni)* | *Sipërfaqja* | *Zona Kadastrale* | *Destinimi* | *Përiudha* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Komuna Pejë | 245-6 | Rr. Adem Jashari | | ZK Pejë | | 35 vite |

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal per vlersimin e ofertave do të inicoj procedurën e tenderimit – ankandit publik, për zgjedhjen e ofertes më të favorshëme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme komunale - ish Zyret e QPS-së, në afat prej tridhjetë e pesë (35)viteve.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlersuesë, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

IV.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**z. Rexhep Kurtbogaj**

**Vendimi ti dërgohet:**
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

HYRËSE - ULAZ
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration
Data: 03.01.2025
-01- 020-8

**SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ**
**I.br: 463/01-98164, dana 30. Decembra 2024.**

Na osnovu odredbi članova 11,12, stav 2 tačka d) i člana 14 stav 1, člana 58 slovo a) b) d) g) Zakona br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosovo i članova 5,6,8 i 14 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni opštinskih imovina, člana 4, člana 5 stav 1.3, člana 6, člana 13 i 14 Pravilnika VRK br.09/2020 o određivanju postupka davanja nekretnina Opštine na korišćenje, kao i člana 20 stav 1 tačka 1.4 Statuta br.01/2020 Opštine Peć I. broj:01-16/01-413431 od 30. Septembra 2020, posle razmatranja predloga Gradonačelnika za načelno usvajanje davanja opštinskih nekretnina-bivših kancelarija CSR-a, po preporuci Komiteta za Politiku i Finansije, Skupština Opštine Peć je na sednici održanoj dana 30. Decembra 2024.godine donela ovu:

**ODLUKU**
**Br. 76/2024**
**O načelnom usvajanju davanja opštinske nekretnine na korišćenje – bivše kancelarije CSR-a**

**I. Usvaja se predlog** Gradonačelnika Opštine za načelno usvajanje davanja opštinskih nekretnina

**Usvaja se** predlog Gradonačelnika Opštine za načelno usvajanje davanja opštinskih nekretnina na dugoročno korišćenje bivših kancelarija CSR-a, na period od 35 godina prema odluci broj 71-2023 o usvajanju posebne liste opštinskih imovina koje će biti date na korišćenje tokom 2024. Godine, sa brojem protokola 463-01/117215 od 28.decembra 2023.godine.

| *Br.* | *VLASNIK Posednik* | *Broj parcele* | *Naziv ulice (lokacija)* | *Površina* | *Katastarska zona* | *Namena* | *Period* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Opština Peć | | Ul. Adem Jashari | | KZ Peć | | 35 godina |

II. Posle ispunjavanja zakonskih uslova, opštinska komisija za procenu ponuda će započeti postupak za javnu licitaciju i biranje najpovoljnije ponude za davanje bivših kancelarija CSR-a na dugoročno korišćenje na period od 35 godina.

III. Za primenu ove odluke i zakonskih odredbi o davanju na korišćenje i razmeni nekretnina Opštine zadužena je Komisija za Procenu i Direktorat za Pravno-imovinska Pitanja.

IV.Ova odluka stupa na snagu 15 dana posle registrovanja u Kancelariji za Protokolisanje u MALV-u, kao i 7 dana posle objavljivanja na web stranici Opštine Peć.

**PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**
**G. Rexhep Kurtbogaj**

**Odluka se dostavljaVendimi ti dërgohet:**
MALV-u,
Gradonačelniku Opštine,
DPIP-u,
Arhivi.

5

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEĆ

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

1. Në bazë të nenit 11, 12 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale ligji nr.06/L092 dhe nenit 20 dhe 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 10.12.2024 pas shqyrtimit të rekomandimit të Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike për dhënien ne shfrytëzim, Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite, merr kete:

**K o n k l u z i o n**

2. **I propozohet** Komitetit Për politik dhe Financa në Pejë, të shqyrton dhe te rekomandon për miratim në Asamblenë Komunale ne Pejë kërkesën e drejtorisë për Çështje Pronësoro Juridike për dhënien ne shfrytëzim Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike janë të parapara të ipen në shfrytëzim për shërbime gastronomike, për 35 vite.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset drejtorati për Çështje Pronësore Juridike

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Komitetit Për Politik dhe Financa
- Sekretarisë se Kuvendit Komunal në Peje dhe
- Arkivit.

**KOMUNA E PEJËS**

**I.nr.** 463/01-98159 **/ 2024**
**Pejë, 10 dhjetor 2024**

**Gazmend Muhaxheri**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**
**Numër: 463-01/117215. dt. 28 Dhjetor 2023.**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 2 pika d, neni 14, neni 58 shkronja a) b) d) g) i) të ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikes së Kosovës dhe në mbështetje të nenit 5, 6, 8 dhe 13 të Ligjit nr. 06/L-092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajshme të Komunës, nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 7, paragrafi 1, pika 1.2 , dhe nenit 76, pararafi 1, të Statutit nr.01/2020, të Komunës së Pejës, I. numër: 01-16/01-413431 datë 30 Shtator 2020, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, dhe në Rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28. Dhjetor 2023, merr këtë:

**VENDIM**
**Nr. 71/2023**
**mbi miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024.**

I. **Miratohet** - Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

II. Pjesë përbërse e këtij vendimi është lista e veqantë e pronave Komunale që parashikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit vijues 2024, konformë Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të Komunës dhe regullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të komunës.

**Lista e Veqantë e Pronave të paluajtshme komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024.**

| Nr. | PRONARI Poseduesi | Nr. i Ngastres | Emri i rrugës | Sipërfaqja | Zona Kadastrale | Destinimi | Përiudha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | KK Pejë | 2816-1 | Rr. Mbreti Piro | 2082 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 2. | KK Pejë | 02834-0 | Rr.Tony Bler | 102 $m^2$ | Pejë | Dhënie në Shfrytezim afat gjatë të pronës se paluajtshme | 99 vite |
| 3. | KK Pejë | 00282-5 | Rr.Adem Jashari | 1768 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 4. | KK Pejë | 03401-0 | Rr.Tony Bler | 6194 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. | KK Pejë | 01093-1 | Rr.Mbretëresha Teutë | 5703 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 6. | KK Pejë | 03339-1 | Rr.Karagaq | 4228 $m^2$ | Pejë | Aktivitete Sportive-rekreative | 35 vite |
| 7. | KK Pejë | 05774-0 | Rr.Nëna Terezë-Të Arkivi | 2768 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 8. | KK Pejë | 01089-1 | Rr.Medeline Olbright-Te QKMF | 1271 $m^2$ | Pejë | Parkingje | 5 vite |
| 9 | KK Pejë | 00167-41 | Fsh.Lutogllavë | 10085 $m^2$ | ZK Lutogllavë | Deponi-Dru | 15 vite |
| 10. | KK Pejë | 00167-42 | Fsh.Lutogllavë | 10086 $m^2$ | ZK Lutogllavë | Deponi-Gomë | 15 vite |
| 11. | KK Pejë | 00167-43 | Fsh.Lutogllavë | 10086 $m^2$ | ZK Lutogllavë | Deponi-Material i Fortë | 15 vite |
| 12. | KK Pejë | | Rr.Hasan Prishtina-Objekti i Komunës | | ZK Pejë | 2 (dy) sportele për aktivitete bankare | 3 vite |
| 13. | KK Pejë | | Rr.Adem Jashari | | ZK Pejë | Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së | 35 vite |
| 14. | KK Pejë | 1757-0 | Rr.Nena Terezë | | ZK Pejë | Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike-për shërbime gastronomike | 35 vite |

III. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni komunal për vlerësimine ofertave do të inicicojë procedurën e ankandit publik për zgjedhjën e ofertës me të favorshme për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave të parapara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënjen në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës, obligohet Kryetari i Komunës, Komisioni Vlerësues dhe Drejtorija për Çështje Pronësoro-Juridike.

V. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**
**z. Rexhep Kurtbogaj**

**Vendimi ti dërgohet:**
1x1 MAPL-së,
1x1 Kryetarit të Komunës,
1x1 DÇPJ,
1x1 Arkivë.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611071-00245-6

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 002631/25 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 13.01.2025 - 15:04 |
| Komuna / Opština / Municipality: | PEJË / PEČ / PEJË |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Pejë / Pec / Pejë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | PEJË / PEČ / PEJË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71611071-00245-6 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 790 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| UL.M.TITA | | | | |

SOLITER I

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Qerim.Morina | P-71611071-00245-6 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Pemishtet/Vocnjaci/orchard | Pemishtë E Klasës 1/Vocnjak 1 Klase/1st Class Orchard | 790 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | P.SH. NDËRMARJA TREGTARE -17 NËNTORI-PEJË | KCID1619601 | PEJË / PEĆ / PEJË / | | | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pejë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71611071-00245-6 | Parcelë / Parcela / Parcel | 790 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Qerim Morina

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 13.01.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:07:07

**Leonora Bajrami**

---

|  |  |
|---|---|
| **From:** | Avni Gashi |
| **Sent:** | Tuesday, January 14, 2025 1:19 PM |
| **To:** | Leonora Bajrami |
| **Cc:** | Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi; Syzana Hajdari |
| **Subject:** | FW: PLOTËSIM INFORMATE |

Pershendetje e nderuara znj. Bajrami, si me poshte ne email nga zyrtarja e drejtorise per ceshtje pronsore – juridike i gjeni:

Lidhur me kërkesën tuaj se nga kush menaxhohen objektet e e listuara si më poshtë **JU NJOFTOJMÊ SE;**

1 Zyret e QPS-së të cilat gjinden neë objektin e Soliterit , në Pejë të cilat janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite e që janë Pronë komunale

2. dhe Zyret në katin e 3 tek Pliklinika Stomatologjike të cilat po ashtu janë të parapara të ipen në shfrytëzim në periudhën prej 35 vite, për shërbime gastronomike

**TË NJEJTAT JANË NËN MENAXHIMIN E KOMUNËS SË PEJËS TË EVIDENTUARA SI INVESTIME KAPITALE SI INVESTIME KAPITALE**

---

**From:** Syzana Hajdari
**Sent:** Tuesday, January 14, 2025 11:56 AM
**To:** Avni Gashi; Rexhep Kurtbogaj
**Cc:** Arianit I Krasniqi; Luan Gashi
**Subject:** PLOTËSIM INFORMATE

Përshëndetje,

Lidhur me kërkesën tuaj se nga kush menaxhohen objektet e e listuara si më poshtë **JU NJOFTOJMÊ SE;**

1 Zyret e QPS-së të cilat gjinden neë objektin e Soliterit , në Pejë të cilat janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite e që janë Pronë komunale

2. dhe Zyret në katin e 3 tek Pliklinika Stomatologjike të cilat po ashtu janë të parapara të ipen në shfrytëzim në periudhën prej 35 vite, për shërbime gastronomike

**TË NJEJTAT JANË NËN MENAXHIMIN E KOMUNËS SË PEJËS TË EVIDENTUARA SI INVESTIME KAPITALE SI INVESTIME KAPITALE**

Me respekt ,
Syzana nga DCPJ

**Leonora Bajrami**

---

**From:** Leonora Bajrami
**Sent:** Tuesday, January 14, 2025 10:49 AM
**To:** Avni Gashi
**Cc:** Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi
**Subject:** RE: PLOTËSIM I KËRKESËS

Përshëndetje,

Ju lutem a mund te na sqaroni se kush menaxhon me **parcelën P-71611071-01757-0 o.O.U.P.Opshta Bolnica(Medicinski Centar)** si dhe me parcelën **P-71611071-00245-6 P.Sh Nderrmarrja tregtare- 17 Nentori Pejë**

Me respekt
Leonora;

---

**From:** Avni Gashi
**Sent:** Tuesday, January 14, 2025 10:01 AM
**To:** Leonora Bajrami
**Cc:** Rexhep Kurtbogaj; Arianit I Krasniqi
**Subject:** FW: PLOTËSIM I KËRKESËS

Pershendetje e nderuara znj. Bajrami, si me poshte ne email dhe attachment nga zyrtarja e drejtorise per ceshtje pronsore – juridike i gjeni:

Bashkëngjitur mund të gjeni:

1. Fletat Poseduese dhe Kop[jen e Planit për Zyret e ish QPS -së, të cilat gjinden në Objektin e Soliterit në Pejë e që janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite e me numer të ngastrës ku ndodhet objekti **nr. 245-6** dhe
2. Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike , e praparë të ipet në shfrytëzim për shërbime gastronomike për 35 vite , me numer të ngastrës **1757-0**

---

**From:** Syzana Hajdari
**Sent:** Tuesday, January 14, 2025 9:57 AM
**To:** Avni Gashi; Rexhep Kurtbogaj
**Cc:** Arianit I Krasniqi; Luan Gashi
**Subject:** PLOTËSIM I KËRKESËS

Përshëndetje,

Bashkëngjitur mund të gjeni:

1. Fletat Poseduese dhe Kop[jen e Planit për Zyret e ish QPS -së, të cilat gjinden në Objektin e Soliterit në Pejë e që janë të parapara të ipen në shfrytëzim për 35 vite e me numer të ngastrës ku ndodhet objekti **nr. 245-6** dhe

2. Zyret në katin e tretë tek Poliklinika Stomatologjike , e praparë të ipet në shfrytëzim për shërbime gastronomike për 35 vite , me numer të ngastrës **1757-0**

Me respekt,

Syzana

## Leonora Bajrami

**From:** Leonora Bajrami
**Sent:** Monday, January 20, 2025 10:13 AM
**To:** Rexhep Kurtbogaj; Avni Gashi
**Subject:** Kerkese...

Përshëndetje,

Po ju shkruaj lidhur me vendimin Nr.76/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien ne shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme komunale ish zyret e QPS-së, vendim i datës 30.12.2024. Ju lutem të mos e publikoni vendimin pasi qe ende jemi ne proces te vlerësimit.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

**Me respekt,**

Republika e Kosovës

**Leonora Bajrami**
**Zyrtare për Monitorim të Komunave**
**Qerveria e Republikës së Kosovës**
**Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal**
**Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave**

PHONE MOBILE EMAIL
**+383 49 500 312** **leonora.bajrami@rks-gov.net**
Adresa: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë ' Ish Rilindja ' Kati 11/1117

**Leonora Bajrami**

| | |
|---|---|
| **From:** | Armend Hamzaj <Armend.Hamzaj@pak-ks.org> |
| **Sent:** | Thursday, January 23, 2025 3:31 PM |
| **To:** | Leonora Bajrami |
| **Cc:** | Xhevat Tafa; Ardita Lokaj; Ardian Berisha |
| **Subject:** | FW: Kerkese per informata |
| **Attachments:** | 1486-2024 PEJ139 Aplikimi në DHPGJS per heqje dorë parcellat 245-5, 566-0 etj ZK Pejë.pdf |

Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sender

Pershendetje Leonora,

Shih meposhte shpjegimet e znj. Ardita Lokaj lidhur me kërkesën tuaj.

Me t'mira,

**Armend K. HAMZAJ**
Drejtor i Departamentit Ligjor
Departamenti Ligjor / Legal Department
Rr. "Dritan Hoxha" Nr. 55, Prishtinë
Tel: +383 (38) 500 400
E-mail:armend.hamzaj@pak-ks.org
Web: http://www.pak-ks.org
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**From:** Ardita Lokaj <Ardita.Lokaj@pak-ks.org>
**Sent:** 20 January 2025 11:01 AM
**To:** Armend Hamzaj <Armend.Hamzaj@pak-ks.org>
**Subject:** RE: Kerkese per informata

Me fal se harrova me e bashkangjit edhe aplikimin ne DHPGJS.

**From:** Ardita Lokaj
**Sent:** 20 January 2025 10:58 AM
**To:** Armend Hamzaj <Armend.Hamzaj@pak-ks.org>
**Subject:** RE: Kerkese per informata

Armend,

Ngastra nr.245-6 është në pronësi të NT 17 Nwntori ( jo edhe object) në këtë ngastër është I ndrëtuar objekti banesor Soliteri ( I ndërtuar viteve 70-80 ka edhe ngastra tjera ), dhe përë këtë ngastër është aplikuar për heqej dorë.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | PEJ | Kushtrim Thaqi | PEJ 139 | 17 Nentori | Pejë | Pejë | PO | PaShitur | P-71611071-00245-6 | 4164 | UL. M. TITA | PEMISHTE | 0 | 790 | Është aplikuar pran DHPGJS për heqje dorë.. Ne kuader te parceles eshte i ndertuar soliteri | 0 | 0 | 790 |

**From:** Armend Hamzaj <Armend.Hamzaj@pak-ks.org>
**Sent:** 20 January 2025 10:50 AM
**To:** Ardita Lokaj <Ardita.Lokaj@pak-ks.org>
**Subject:** Fwd: Kerkese per informata

Ardita,

A mundeni me trajtu kete ceshtje.

Armendi

**From:** Leonora Bajrami <leonora.bajrami@rks-gov.net>
**Date:** 20 January 2025 at 10:21:55 CET
**To:** Armend Hamzaj <Armend.Hamzaj@rks-gov.net>
**Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
**Subject: Kerkese per informata**

Përshëndetje,

Me qellim të qartësimit të Vendimit Nr.76/2024 mbi miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme komunale ish zyret e QPS-së KK Pejë, Ju lutem a mund të na sqaroni se prona e cekur në vendim a është në pronësi të AKP-së apo te komunës së Pejës ashtu siç na kane konfirmuar drejtoria për çështje pronësore Pejë.

Andaj mundësisht të na ktheni një përgjigje në kohe sa më të shkurtër.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

**Me respekt,**

**Leonora Bajrami**
**Zyrtare për Monitorim të Komunave**
**Qerveria e Republikës së Kosovës**
**Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal**
**Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave**

PHONE

MOBILE

EMAIL

+383 49 500 312 leonora.bajrami@rks-gov.net

Adresa: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë ' Ish Rilindja ' Kati 11/1117

PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO
NSH OP SOE PEJ139
Në Likuidim / U Likvidaciji / In Liquidation
Nr. 1486-2024
26 Data 12.02.2024

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për: Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ("Dhoma e Posaçme") Prishtinë, Kosovë

Parashtruesi: Agjencia Kosovare e Privatizimit - Autoriteti i Likuidimit i PEJ139 NSH "17 Nëntori" (Në likuidim) Fi-545/89.

Datë:

Lënda: Aplikim për të marrë leje nga Dhoma e Posaçme për të hequr dorë ngastrat P-71611071-00245-5;P-71611071-00245-6;P-71611071-00566-0; P-71611071-00567-0 dhe P-71611071-00568-0 në pronësi të NSh "17 Nëntori"

Autoriteti i Likuidimit i PEJ139 NSH "PEJ139" (Në likuidim), i emëruar me 14.10.2005 ka shqyrtuar të gjitha kërkesat kreditore të paraqitura.

Autoriteti i Likuidimit i PEJ139 NSH "17 Nëntori" (Në likuidim), në pajtim me nenin 18, paragrafin 3 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dorëzon këtë aplikim për të marrë lejen për heqjen dorë nga asetet në vijim të NSH "17 Nëntori".

Ngastrat kadastrale nr. P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m²; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m²; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m²; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m² dhe P-71611071-00568-0 232 m² ZK Pejë në certifikatën e pronësisë tek pjesa e shfrytëzimit nuk është i evidentuar lloji i shfrytëzimit të parcelave. Në parcelat që janë objekt i kësaj kërkese nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit për arsye se në këto parcela janë të ndërtuar objekte të banimit kolektiv. Poashtu, një pjesë e këtyre parcelave siç mund të vërehet janë rrugë dhe trotuara përreth këtyre objekteve banesore.

**Baza Ligjore:**

Sipas Shtojcës se Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykates, mund të heqë dorë nga një aset për rastet si në vijim:

1. Neni 18, par. 3.1 i Shtojcës se Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili parasheh rastet kur "Aseti është problematik apo joprofitabil dhe i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës";
2. Neni 18, par. 3.2 i Shtojcës se Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili percakton qe mund te hiqet dore nga "çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoriteti i Likuidimit apo Gjykatës".

Në Nenin 3, paragrafi 10, pika 4 të Rregullores Nr. 4/2020 për Politika dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, parashihet që "Duke iu nënshtruar aprovimit të DHPGJS-së të kërkesës të cilën AL-ja ia parashtron asaj, AL-ja mund të heq dorë prej një aseti ose disa aseteve të NSH-së në rrethana të caktuara sipas nenit 18.3.1 dhe 18.3.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në". Poashtu, në këtë nen përcaktohet edhe që të gjitha kërkesat për heqje dorë të aseteve paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve para se të dorëzohen në Dhomën e Posaçme sipas ligjit.

Për më tepër, me Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve janë të përcaktuara procedurat mbi heqjen dorë nga asetet në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore, që nga inicimi i procedurës, shkaqet mbi të cilat mund të hiqet dorë nga ana e aseteve dhe deri tek veprimet që duhet të ndërmirren pas vendimit të DhPGJSK-së mbi kërkesën për heqje dorë nga ana e asetit.

Sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, asetet nuk janë në gjendje të kenë realizim fitimprurës dhe ndaj këtyre aseteve nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, dhe për këtë arsye, ashtu si është sqaruar më detajisht në arsyetimin më poshtë, Autoriteti i Likuidimit aplikon të Dhoma e Posaçme të na jap lejen për të hequr dorë nga asetet.

## ARSYETIM

PEJ139 NSH "17 Nëntori" (në likuidim), është nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe po administrohet nga Autoriteti i Likuidimit, i emëruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Duke pasur parasysh që parcelat nr. P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m²; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m²; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m²; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m² dhe P-71611071-00568-0 232 m² ZK Pejë janë ndërtuar ndërtesa/objekte për banim kolektiv që nga vitet e shtatëdhjeta (70-ta) Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, për shkak se në kemi të ndërtuar objekt banimi kolektiv, një pjesë është rrugë dhe hapësirë tjetër publike që shfrytëzohen për interes publik.

Sipas praktikës së pronës shoqërore, toka brenda zonave urbane ishte e dedikuar për ndërtimin e objekteve të banimit dhe ndërtesave, dhe kategorizohej si "tokë ndërtimore". Qytetarët fitonin të drejtën e pronësisë mbi objektin banesor por, të garantuar e kishin vetëm të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të tokës ndërtimore mbi të cilën ishte ndërtuar objekti[1].

Bazuar në nenin 9 par. 1 të Projektligjit për Tokën Ndërtimore (projektligj i aprovuar në mbledhjen e 42-të të Qeverisë së Kosovës me vendimin Nr. 04/42 të datës 27.10.2021) *"Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi private apo publike"* lidhur me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Autoriteti i Likuidimit konsideron që këto parcela duhet të barten në emër të KK Mitrovicë e Veriut pasi që nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv dhe është pastaj obligim i KK Mitrovicë e Veriut që në përputhje me legjislacionin aktual të ju ofrojë siguri juridike edhe banorëve të ndërtesës të ndërtuar në parcelën objekt i kësaj kërkese, të bëj azhurnimet e duhura në regjistrat kadastral.

Në këto raste, siguria juridike për pronarët/shfrytëzuesit e njësive banesore është e garantuar edhe në rast se ndërtesa shkatërrohet ose zhvlerësohet, ku pronari/pronarët e ndërtesës kanë të drejtën e përparësisë për të ri-ndërtuar ndërtesën. Vetëm nëse e drejta e përparësisë nuk është përdorur, toka kthehet në autoritetin administrativ të komunës e cilat pastaj mund të japë të drejtën e përdorimit një personi tjeter[2].

Poashtu, nuk mund të bëhet bartja e pronësisë së parcelave nga KK Pejë në emër të personave privat, për arsye se këto janë ndërtesa të destinuara për banim kolektiv dhe nuk posedojmë ndonjë dëshmi që ndonjë personi i është dhënë me vendim e drejta mbi shfrytëzimin e përhershëm të tokës ndërtimore

---

[1] Qeveria e Republikës së Kosovës, *Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë*, Dhjetor 2016, fq. 22.
[2] Qeveria e Republikës së Kosovës, *Memorandum Shpjegues për Projektligjin për Tokën Ndërtimore*, fq. 3.

apo ka të drejtën e pronësisë në ndërtesat e ndërtuara në tokën ndërtimore, në të cilën ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm, sipas ndonjë pune tjetër juridike siç është dhënia në shfrytëzim të përhershëm e tokës ndërtimore, me kompensim apo pa kompensim, për ndërtimin e ndërtesave.

Këto parcela, siç mund të vërehet edhe nga raporti i vizitës në terren përfshijnë në tërë sipërfaqen e tyre, hapësirën mbi të cilën janë të ndërtuara objekte banesore dhe poashtu një pjesë e këtyre parcelave është rrugë dhe trotuare përreth këtyre objekteve.

Pas aprovimit të kësaj kërkese të Autoritetit të Likuidimit nga ana e DHPGJS, atëherë në përputhje me nenin 42 par.2 të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i cili specifikon që *"Në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria" pronësia mbi këtë aset do të kalojë mbi organin publik kompetent"*.

Duke pasur parasysh faktet dhe arsyet të paraqitura si më lart, Autoriteti i Likuidimit i kërkon Dhomës së Posaçme të marrë lejen për të hequr dorë nga ngastrat kadastrale P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m$^2$; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m$^2$; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m$^2$; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m$^2$ dhe P-71611071-00568-0 232 m$^2$ ZK Pejë siç përshkruhet në certifikatën e datës 06.03.2010.

Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit i NSh "17 Nëntori" PEJ139 (Në likuidim)

Miftar Salihi
Kryesues i Autoritetit të Likuidimit i NSh "17 Nëntori"

**Shtojcat e Bashkëngjitura:**

1. Kopja e vlerësimit/përcaktimit të miratuar të gjendjes (Raporti i Gjendjes në Terren);
2. Raporti i Gjendjes së Proceseve të Ndërmarrjes Shoqërore;
3. Kopja e Njoftimit mbi Fillimin e procedurës së Likuidimit dhe Emërimit të Anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit;
4. Kopja e Njoftimeve për Fillimin e procedurës së Likuidimit në gazetat ditore;
5. Kopja e Vendimit për Emërimin e Autoritetit të Likuidimit;
6. Kopja e certifikatës së pronësisë e datës 06.03.2010;
7. Rekomandimi i Autoritetit të Likuidimit për Bordin e Drejtorëve për të hequr dorë nga aseti datë 15.05.2024;
8. Vendimi nga ana e Bordit të Drejtorëve datë 23.05.2024 për të hequr dorë nga aseti.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# RAPORT I VIZITËS NË TEREN

| | | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| Vizita realizuar nga zyrtari/ët: | Lindita Agushi - Zyrtare e rastit për NSH 17 Nëntori në Pejë | [signature] |
| NSH-ja: | NSH 17 Nëntori, Pejë | |
| Vendndodhja e asetit /Zona Kadastrale: | ZK Pejë, komuna Pejë | |
| Aseti/et/parcela/t | Parcela 245/5, 245/6, 566, 567 dhe 568 | |
| Raport: mujor/ tremujor/i rregullt | Raport për heqje dorë | |
| Problemi/et i/e identifikuar/a nëse ka (Po/Jo) | | |
| Datë e Vizitës | 24.04.2024 | |

Me datë 24.04.2024 janë vizituar parcelat e lartpërmendura te cilat janë në emër të NSH 17 Nëntori me qëllim të kontrollimit të gjendjes së parcelave të propozuara për heqje dorë, respektivisht parcela kadastrale si në vijim:

- Parcela 245/5 në sipërfaqe 519 m2
- Parcela 245/6 në sipërfaqe 790 m2
- Parcela 566 në sipërfaqe 383 m2
- Parcela 567 në sipërfaqe 186
- Parcela 568 në sipërfaqe 232 m2

Sipas gjendjes faktike ne teren në kuadër të këtyre parcelave është i ndërtuar objekti banesor "Soliteri" si dhe një pjese është trotuar.





**Ortofoto**



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**RAPORTI I GJENDJES SË PROCESEVE TË NDËRMARRJES SHOQËRORE** 17 Nentori
për datën 26-Nov-13
kodi rajonal PEJ133 ref. Master Listë 182

| | |
|---|---|
| Emri i NSH-së | 17 Nentori |
| Selia e NSH-së | Pejë |
| Rajoni | Peja |
| A është NSH apo aset | Ndërmarrje Shoqërore |
| A është NSH në likuidim | PO |
| Data e vendosjes në likuidim | 14-Oct-05 |
| Emri i Kryesuesit të AL-së | Miftar Salihi |
| Emri i Zyrtarit të Rastit | Kushtrim Thaqi |

**FONDET E LIKUIDIMIT TË 17 Nentori TË TRANSFERUARA NË FONDIN E KONSOLIDUAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

| | | |
|---|---|---|
| Fonde tepricë (surplus funds) - neni 10.3 i ligjit | | 183,660 |
| Fonde të mbetura (residual funds) - neni 2.2.0 i ligjit | | - |
| Fonde të përkohshme (temporary funds) - neni 2.2.7 i ligjit | | 6,329,340 |
| GJITHSEJ | € | 6,513,000 |

**GJENDJA AKTUALE E FONDEVE SIPAS LLOJIT TË LLOGARIVE BANKARE**

| | | |
|---|---|---|
| Likuidim | | 951,425 |
| Privatizim | | - |
| Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët | | 928 |
| Para të NSH-ve në mirëbesim | | - |
| GJITHSEJ GJENDJA AKTUALE E LLOGARIVE BANKARE | € | 952,353 |

A është mbyllur NSH-ja me vendim të Dhomës së Posaçme (PO /JO) JO

**INFORMATA PËR ASETET BRENDA KOSOVËS**

| | nr. aseteve të shitura | hektarë | shuma e shitjes |
|---|---|---|---|
| Asete tjera të shitura | 45 | | € 9,692,922 |
| Toka bujqësore të shitura | 0 | 0.00 | € - |
| Llojet tjera të tokave të shitura* | 2 | 0.04 | € 44,760 |
| Gjithsej asete të shitura | 47 | 0.04 | € 9,737,682 |

| | nr. aseteve të pashitura | hektarë |
|---|---|---|
| Asete tjera ende të pashitura | 10 | |
| Toka bujqësore ende të pashitura | 0 | 0.00 |
| Llojet tjera të tokave ende të pashitura**** | 19 | 0.93 |
| Gjithsej asete të pashitura | 29 | 0.93 |

* Në llojet tjera të tokave janë kategorizuar tokat jo-bujqësore, pra tokat, tokat komerciale, tokat industriale dhe tokat ndërtimore.

| | |
|---|---|
| Sa asete i ka jashtë Kosovës | 0 |
| Sa banesa i ka të pashitura | 0 |
| A ka shpronësim dhe sa asete | 0 |

| NUMRI I ASETEVE TË SHITURA DHE VLERAT | numri i aseteve | vlera e shitjes |
|---|---|---|
| mënyrat e shitjes | 47 | € 6,737,592 |
| spin off i rregullt | 1 | 4,109,881 |
| spin off special | - | - |
| spin off me kushte të veçanta | - | - |
| aset në likuidim | 43 | 6,591,047 |
| ankand publik | - | - |
| negociata direkte | 2 | 22,014 |
| negociata direkte - ndërtime | 1 | 13,200 |
| negociata direkte - karakter tjetër specifik | - | - |
| shitje e banesave | - | - |

| | INFORMATAT THEMELORE TË LIKUIDIMIT DERI 17 Nentor | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i kërkesave kreditore të dorëzuara në likuidim | | 569 | |
| | Kërkesat kreditore të aprovuara (tërësisht dhe pjesërisht) | | 67 | 12% |
| | Kërkesat kreditore të refuzuara | | 502 | 88% |
| | Kërkesat kreditore ende të pavendosura | | - | 0% |
| | Shumat e kërkesave kreditore të aprovuara | € | 209,000 | 3% |
| | Shumat e kërkesave kreditore të refuzuara | € | 5,805,144 | 97% |
| | Shumat e kërkesave kreditore ende të pavendosura | € | - | 0% |
| | Shuma e shpërndarjes së pagesave për kreditorët (aprovuar nga Bordi) | € | 212,607 | |
| | Shuma e shpërndarjes së pagesave për kreditorët (paguar) | € | 209,839 | |
| | Shuma e shpërndarjes së pagesave për kreditorët (ende pa paguar) | € | 2,768 | |
| 1 | Fondi rezervë (sipas nenit 42.1.4 shtojca e ligjit) për kërkesat e ardhshme të cilat do të paraqiten me siguri, por që në kohën e Afatit për Parashtrimin e Kërkesave nuk ishin të konstatueshme | | € 0 | |
| 2 | Fondet e mbajtura rezervë për vendimet e aprovuara nga AL-ja, por që nuk janë paraqitur në Bord për shpërndarje, sepse nuk ka fonde të mjaftueshme | | € 0 | |
| 3 | GJITHSEJT FONDET E REZERVUARA (për rastet që janë dorëzuar Raportet e Shpërndarjes në Bord) | | € 0 | |
| | Minus fondet e përkohshme transferuar Fondit të Konsoliduar të Rep. së Kosovës | | -6,329,340 | |
| | Gjendja aktuale e fondit rezervë | | -€ 6,329,340 | |

| Për NSH-të që NUK ka pasur shpërndarje për kreditorët deri gushi 2010 | | vlera e ankesave | numri I ankesave |
|---|---|---|---|
| KUR DIJMË Vlerën e të GJITHA ankesave për NSH-në e caktuar, sa është Vlera e ankesave | € | - | 0 |
| Kur NUK dijmë të gjitha ankesat për një NSH-në të caktuar, sa është Vlera e atyre ankesave që dihen | € | 461,109 | 206 |
| Për këto ankesa nuk dihet vlera e ankesave | | | 0 |
| **Për NSH-të që KA pasur shpërndarje për kreditorët deri gushi 2010** | | | |
| Ankesat e zgjidhura për NSH-të që ka pasur shpërndarje deri gushi 2010 | € | - | 0 |
| Numri I ankesave që nuk dihet shuma për NSH-të që ka pasur shpërndarje deri gushi 2010 | | | 0 |
| Vlera e 0 kerkesave kreditore të refuzuara, për të cilat jane deklaruar 'fondet rezerve' për ankesa të mundshme në DHP | € | - | 0 |
| GJITHSEJ | € | 461,100 | 213 |

| SHITJA E BANESAVE TË NSH-ve PËR 17 Nentori | numri I banesave | Vlera e shitur |
|---|---|---|
| Numri I kërkesave për blerje të banesave | 1 | |
| Aprovuar nga Bordi | 1 | € 801 |
| Refuzuar nga Bordi | 0 | |
| Të pasqyruara | 0 | |
| Të pashitura ende | 0 | |

| LIDHUR ME 20%-in E PUNËTORËVE PËR 17 Nentori | |
|---|---|
| Gjithsej paguar BSPK-së | € 1,005,900 |
| Fondet e gatshme për shpërndarje pas vendosjes së ankesave nga Dhoma e Posaçme | € 920 |
| Sa është numri aktual I ankesave të punëtorëve në Dhomën e Posaçme | ka vendim final të Dhomës |
| Sa është numri aktual I të kundërshtuarve në Dhomën e Posaçme | ka vendim final të Dhomës |

| SHPRONËSIMET, KTHIMET E PRONAVE, QIRATË | |
|---|---|
| Sa është numri I vendimeve të Qeverisë për shpronësim | 0 |
| Sa është numri I vendimeve të Qeverisë për kthimin e pronave Komunave | 0 |
| Asetet me qira | 1 |
| Asete pa qira | 20 |

**NOTICE**
**of**
**Commencement of Liquidation**
**&**
**Appointment of the first members of the Liquidation Committee**

Name of Enterprise: N.T. Sh "17 Nëntori", Pejë – Fi 545/89

Pursuant to the resolution of the Board of the Kosovo Trust Agency made on 13 October 2005, the Liquidation of the above Enterprise is commenced with effect from:

14 October 2005

Pursuant to the authority granted to the Managing Director of the KTA by the resolution made on 13 October 2005, the following persons are appointed with effect from the date of this Notice as the first members of the Liquidation Committee in accordance with S.39.2 of UNMIK Regulation 2001/6 on Business Organisations and S.9.2 of UNMIK Regulation 2002/12 on the Establishment of the Kosovo Trust Agency as amended by UNMIK Regulation 2005/18:

Josep Desquens – Privatisation Transaction Officer - Chairman
Ardita Lokaj – Enterprise Development Officer
Ardian Berisha – Accounting Control Officer
Denis Garland – Liquidation Officer – Pristina HQ
Fatos Ukaj – Liquidation Officer – Pristina HQ

.................................... Date: 14.X.05..................

J Dick
Managing Director
Kosovo Trust Agency

## KOSOVO TRUST AGENCY

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit • Kosovska Agencija Poverenja

### NJOFTIM PËR LIKUIDIM

[illegible]

## KOSOVO TRUST AGENCY

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit • Kosovska Agencija Poverenja

### NJOFTIM PËR LIKUIDIM

[illegible]

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
[illegible]

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
[illegible] Beograd, Serbi.

[illegible]

## KOSOVO TRUST AGENCY

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit • Kosovska Agencija Poverenja

### NOTICE OF LIQUIDATION

OF

[illegible]

## KOSOVO TRUST AGENCY

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit • Kosovska Agencija Poverenja

### NOTICE OF LIQUIDATION

OF

[illegible]

[illegible] NOTICE IS HEREBY GIVEN [illegible]

Any person who believes he/she has a claim against the Enterprise [illegible]

To obtain the Liquidation Claim form contact the offices of the KTA at:

Kosovo Trust Agency
[illegible]

or

Kosovo Trust Agency
[illegible] Beograd, Serbia.

The claim forms may also be obtained from the KTA web site at [illegible]. For details on how to file a claim see "How to register a claim."

A list of assets and a list of claimants will be maintained at Kosovo Trust Agency [illegible] 30 November 2005 [illegible]

The assets will be offered for sale by sealed bid tender at a date to be advertised in the same manner and in the same location as this notice, including on the KTA web site.

3.5.1.5

# [illegible]

NJOFTIM PËR SHITJE PUBLIKE

Shitja Nr. PEJ 0601

Shitja e pasurisë së përmendur në listën e mëposhtme kryhet nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (këtu e më poshtë "Agjencia") ose nga çdo person që vepron në emër të ose me [illegible] e Agjencisë. Agjencia dhe agjentët e saj veprojnë si administratorë për [illegible] në shkurt.

Ko[illegible] përshkruhen "Rregullave të Tenderit për Shitje Pasurie Përmes një Procesi [illegible] Konkurrues me oferta të mbyllura" (këtu e më poshtë "Rregullat e Tenderit") [illegible] termat dhe kushtet ligjore të shitjes.

[illegible] e Ofertimit — Oferta e mbyllur, me numrin e artikullit të identifikuar. Ofertuesi duhet [illegible] dorëzojnë ofertat e tyre në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në Formularin zyrtar të Ofertës [illegible] Zarfat e Ofertës të cilat u janë dhënë atyre në kohën e [illegible]. Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur.

[illegible] Ofertuesi që dorëzon ofertë për më shumë se një artikull duhet të dorëzojnë një ofertë të [illegible] e mbyllur për secilin artikull individual.

[illegible] e Dorëzimit të Ofertave — Të gjitha ofertat duhet të mbërrijnë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit mes orëve 10:00 dhe 12:00 (ora e Prishtinës) me datë 02 Mars 2006.

Vendi(et) e Marrjes së Ofertave — Hotel GOLD, Salla për konferenca, Pejë.

Data/Koha dhe Vendi i Hapjes së Ofertave — Ofertat do të hapen publikisht në Hotel GOLD, Salla për konferenca, Pejë në ora 12:15 (ora e Prishtinës) me datën 02 Mars 2006.

| Numri i artikullit | Përshkrimi i pasurisë dhe vendndodhja | Depozita e Ofertës (nëse ka) | Data/Orët e Inspektimit |
|---|---|---|---|
| 01 | Shitorja nr. 1 (ish dyqani i tekstilit lokacioni Rruga Rinia, p.n. Istog parcela nr. 1774 FP 828) 50m² | 5,500 | Prej datës 13 Shkurt deri me datën 23 Shkurt 2006<br>Vizita:<br>09:00 – 12:00 dhe 14:00 – 17:00 |
| 02 | Shitorja nr. 2 (ish dyqani i mobilieve lokacioni Rruga Rinia, p.n. Istog parcela nr. 1774 FP 828) 216m² | 10,000 | Njëjtë si më lartë |
| 03 | Shitorja nr. 3 (ish Libraria me kafiteri lokacioni Rruga Rinia, p.n Istog parcela nr. 1774 FP 828) 78 m² | 7,000 | Njëjtë si më lartë |
| 04 | Shitorja nr. 4 (ish dyqani i ushqimorës lokacioni Rruga Rinia, p.n Istog parcela nr. 1774 FP 828) 49 m² | 5,000 | Njëjtë si më lartë |

Pagesa: Siç parashikohet në pikën 11.1 të Rregullave të Tenderit, Agjencia nuk do të pranojë pagesa në të holla përveç për blerjet që nuk kalojnë shumën prej 1,500 €.

Informacioni bankar: Pagesat e kërkuara, ku përfshihen taksa e regjistrimit prej 50 € dhe depozita e ofertës duhet të derdhen direkt në llogarinë(të) e mëposhtme të AKM-së në BPK:

Taksa e regjistrimit: Emri i llogarisë — AKM Likuidimet taksat e regjistrimit
Numri i llogarisë — 1 000 510 000 000 173

Depozita e Ofertës: Emri i llogarisë — AKM Likuidimet Depozita e Ofertës
Numri i llogarisë — 1 000 510 000 000 076

Dispozita të përgjithshme — Gjithë pasuritë e futura në listë këtu ofrohen për shitje "siç është" dhe "ku është" dhe do të shiten në përputhje me kushtet e punës ligjore të shitjes. Në mënyrë të veçantë dhe pa ndryshuar këto kushte, AKM-ja nuk jep asnjë garancion, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar lidhur me kushtet ose përshkrimin e pasurisë që shitet, ose përshtatshmërinë e saj për ndonjë përdorim ose qëllim. Ofertuesi ka përgjegjësinë të verifikojë përshkrimin dhe kushtet e gjithë pasurisë.

Për të siguruar qasjen ndaj pasurisë dhe të dhënat e lidhura me inspektimin, mund të nevojitet autorizimi paraprak i AKM-së.

[illegible] për oferte, ofertuesi duhet të bëjë kërkesë për tu [illegible] specifikohet në formularin e regjistrimit të [illegible] 23 Shkurt 2006 në përmbajtjen e orarit të punës, duke [illegible] formularin e regjistrimit të ofertes(ave) kontakti(eve) të [illegible] Agjencia do të përfshijë në Regjistrin e Ofertuesve të Mundshëm [illegible] kanë plotësuar kërkesat e regjistrimit për oferte [illegible] do ti lëshohet një kopje e formularit të regjistrimit të ofertuesit i [illegible], një numër regjistrimi i ofertuesit ("Numri i [illegible] oferte të mbyllur dhe zarf(a) të ofertës.

[illegible] potencial do t'u kërkohet të paguajnë një taksë regjistrimi të [illegible] prej 50 Euro. Në kohën e dorëzimit të dokumentacionit [illegible] dorëzohet edhe një vertetim i rregullt pagese në një nga llogaritë e [illegible]

[illegible] Likuidimi (emri i tanishëm dhe i mëparshëm, dhe numri i [illegible]

Wholesale and Retail Trade Enterprise "17 Nentori" /

[illegible] me shumicë dhe pakicë "17 Nentori" /

[illegible] Preduzeće na veliko i malo "17 Nentori" /

[illegible] 4589 (Commercial Court Gjakova, Gjykata Ekonomike Gjakovë, Privredni Sud Gjakova)

[illegible] dhe Nr. Fi.

Wholesale and Retail Trade Enterprise "17 Novembar" /

Ndërmarrja tregtare me shumicë dhe pakicë "17 November" /

Trgovinsko Preduzeće na veliko i malo "17 Novembar" /

[illegible] 2892 (Commercial Court Pristina, Gjykata Ekonomike Prishtinë, Privredni Sud Pristina)

Wholesale and Retail Trade Enterprise "17 Novembar" JSC in mixed ownership /

Ndërmarrja tregtare me shumicë dhe pakicë "17 November" Shoqëri aksionare në [illegible]

Trgovinsko Preduzeće na veliko i malo "17 Novembar" D.D. u mešovitoj svojini /

[illegible] (Commercial Court Pristina, Gjykata Ekonomike Prishtinë, Privredni Sud Pristina)

[illegible]

Kontaktet –

AKM, ZR Pejë Rruga Ardian Krasniqi Nr. 2 (ish Djurdjina Jovicevic)

Orari i punës: E Hënë - E Premte, 8:30-17:30

Numri i tel 039 32-570 lok 109

Fax 039 31-564

e-mail: kta.peja@eumik.org

Nëse jeni anëtar i një pakice etnike në Kosovë dhe keni nevojë për ndihmë për tu para-regjistruar ose për të dorëzuar ofertën, ju lutemi kontaktoni Zyrën Rajonale të paktën 10 ditë para Datës së Hapjes të Ofertave.

Formularë dhe Dokumente – Ofertuesit mund të tërheqin formularët e regjistrimit të ofertuesit, Rregullat e Tenderit dhe kushtet e punës [illegible] të shitjes nga faqja e internetit e Agjencisë www.kta-kosovo.org nën titullin "Likuidim".

Njoftimi i Kërkesave

Personat që besojnë se kanë kërkesë të vlefshme në lidhje me pasuritë e sipër përmendura ose entitetet që zotërojnë/zotëronin ato (duke përfshirë, edhe pse nuk kufizohet vetëm te, (i) kërkesa nga personat që besojnë se janë pronarë të ligjshëm të ndonjë prej entiteteve ose pasurive të përmendura më lart ose të ndonjë pjese të tyre ose pasardhësit e vlefshëm të tyre, ose (ii) kërkesa nga kreditorët) duhet të dorëzojnë pa vonesë këto kërkesa, së bashku me një përshkrim të plotë dhe gjithë dokumentacionin mbështetës, në Zyrën Rajonale të AKM. Komisioni(et) i Likuidimit i emëruar nga AKM do të analizojë kërkesat e dorëzuara dhe dokumentet mbështetëse shoqëruese për të përcaktuar se kujt duhet t'i bëhen pagesat nga shuma e shitjes në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm. Duhet vënë në dukje se, sipas Ligjit të Zbatueshëm, është e mundshme që 20% e të ardhurave nga shitja do t'u paguhen fillimisht punonjësve të përshtatshëm, pasuar nga pronarët e tokës dhe kërkesat e siguruara, më pas kreditorët e pasiguruar, dhe më pas pronarët e entiteteve kur përcaktohet se entitetet janë transformuar në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe në mënyrë jo-diskriminuese.

AKM nuk do të vendosë mbi kërkesat si organ, polimaj gjyqësor ose administrativ, për pasojë, dorëzimi i kërkesave në AKM, që që AKM [illegible] kërkuesit e mundshëm të bëjë [illegible] nuk parandalon kërkuesit e mundshëm të dorëzojnë edhe kërkesë në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, edhe të ndjekin mjetet e kundërshtimit me rrugë gjyqësore të ndonjë vendimi të AKM në gjykatën e duhur.

Për formularët e kërkesave dhe detajet se si të dorëzohet kërkesa shih www.kta-kosovo.org "Si të regjistrohet kërkesa" ose, të tërhiqet formulari nga zyra e AKM. Kërkesat mund të dorëzohet po ashtu në zyrën e Shtyllës të BE në Beograd për të cilën adresa është Shtylla IV e BE-së Zyra e Beogradit, Tolstojeva 47, 11000 Beograd, Serbi. Rregulloret përkatëse të UNMIK paraqiten të lidhura në faqen e internetit të AKM si më lart.

**NJOFTIM PËR SHITJE PUBLIKE**

**Shitja Nr. PEJ 0701**

Shitja e pasurisë së përmendur në listën e mëposhtme udhëhiqet nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë "Agjencia") ose nga çdo person që vepron në emër të ose me autorizimin e Agjencisë. Agjencia dhe zyrtarët e saj veprojnë si administratorë për Ndërmarrjen që është vënë në likuidim.

Kjo shitje i nënshtrohet "Rregullave të Tenderit për Shitje Pasurie Përmes një Procesi të Shitjes me Oferta të mbyllura" (në tekstin e mëtejmë "Rregullat e Tenderit") dhe (ii) kushteve dhe afateve ligjore të shitjes.

**Metoda e Ofertimit** – Ofertë e mbyllur, me numër e mesme së identifikuar. Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertat e tyre në Formularin e Ofertës zyrtare të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në Zarfet e mbyllura të ofertës të cilat u janë dhënë atyre në kohën e regjistrimit.

Ofertuesit të cilët dorëzojnë oferta për më shumë se një njësi duhet të dorëzojnë nga një ofertë të veçantë të mbyllur për secilën njësi veç e veç.

**Periudha e Dorëzimit të Ofertave** – Gjithë ofertat pranohen në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit mes orëve 10:00 dhe 12:00 (ora e Prishtinës) më 30 Nëntor 2007.

**Vendi(et) i Pranimit të Ofertave** – Hotel Royal Arda Pejë

**Data/Koha dhe Vendi i Hapjes së Ofertave** – Ofertat do të hapen publikisht në Hotel Royal Arda në Pejë në orë 12:15 (ora e Prishtinës) më 30 Nëntor 2007.

**Pranueshmëria e Ofertuesve** – Ofertuesit duhet të plotësojnë kërkesat e pranueshmërisë sipas Rregullave të Tenderit.

**Regjistrimi** – Për të qenë i pranueshëm për ofertë, ofertuesi duhet të bëjë kërkesë për t'u regjistruar (me dokumentacionin e kërkuar siç specifikohet në formularin e regjistrimit të ofertës) të paktën pesë (5) ditë pune para dorëzimit të ofertave dhe datës së hapjes së ofertave, duke plotësuar, nënshkruar dhe dërguar formularin e regjistrimit të ofertës(ave) kontakt(eve) të përmendur më poshtë. Agjencia do të përshijë në Regjistrin e Ofertuesve të Mundshëm vetëm ata që Agjencia përcakton se kanë plotësuar kërkesat e regjistrimit për ofertë. Ofertuesve të regjistruar do t'u lëshohet një kopje e formularit të regjistrimit të ofertuesit i plotësuar tërësisht, i nënshkruar dhe i vulosur, një numër regjistrimi i ofertuesit ("Numri i Ofertuesit"), formular(ët) zyrtare të vulosur të ofertës dhe zarfin(at) e ofertës.

Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim – emri dhe Fi- numri:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 08 | Shitorja ish "NASHDOM" Rr. 129/2 ish Sheshi i Republikës (133 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 9,800 | Njëjtë si më lartë |
| 09 | Shitorja "NOSHI" Rr. 129/2 ish Sheshi i heronjve (63 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 7,150 | Njëjtë si më lartë |
| 10 | Shitorja ish "SNABZANAT" Rr. 129/2 ish Vllazërim bashkim (59 m²), pjesë e parcelës 687/1 | NT "17 Nëntori" | 9,750 | Njëjtë si më lartë |
| 11 | Shitorja ish "TEHNOMETAL" Rr. 129/2 ish Vllazërim bashkim (Në sipërfaqe të përgjithshme prej 245 m² objektet përdhesë + obori - Fletëposedimi nr. 2975 parcela 910/3), Pejë | NT "17 Nëntori" | 9,700 | Njëjtë si më lartë |
| 12 | Objekti i Dajës së Tepihëve Vrellë [illegible] (200 m²) | N.P. TQ Vrella | 5,000 | Njëjtë si më lartë |

**Pagesa** – Siç parashikohet në pikën 11.1 të Rregullave të Tenderit, Agjencia nuk do të pranojë pagesa në të holla përveç për blerje që nuk kalojnë shumën prej €1,500.

**Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)** – TVSH nuk përfshihet në ofertë. Blerësi do të paguaj çmimin e ofertës dhe me pas edhe TVSH-në rast se është e aplikueshme. Agjencia do ta marrë përcaktimin nga Administrata Tatimore e Kosovës se a është TVSH-ja e aplikueshme për çdo shitje.

**Informacioni bankar** – Të gjitha pagesat për depozitat duhet të bëhen drejtpërsëdrejti në llogarinë e AKM-së pranë Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK)

**Depozita e Ofertës** – Emri i llogarisë: AKM Likuidimet – Depozita e ofertës
Numri i llogarisë: 1 000 510 000 000 076

**Dispozita të përgjithshme** – Gjithë pasuritë e listuara këtu ofrohen për shitje "si është" dhe "ku është", dhe do të shiten në përputhje me kushtet dhe bazat ligjore të shitjes. Në mënyrë të veçantë dhe pa ndryshuar këto kushte, AKM nuk lep asnjë garanci, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, lidhur me kushtet ose përshkrimin e pasurisë që shitet, ose përshtatshmërinë e saj për ndonjë përdorim ose qëllim. Ofertuesi ka përgjegjësinë të verifikojë përshkrimin dhe kushtet e gjithë pasurisë.

Për të siguruar qasjen ndaj pasurisë dhe ndaj të dhënave për inspektim, kërkohet autorizim paraprak nga AKM-ja.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit do t'u lejojë ofertuesve të shikojnë të dhënat dhe

[illegible] Ekonomike Prishtinë)

[illegible] "17 Nëntori", Shoqëri aksionare [illegible] (Zyra e [illegible] Ekonomike Prishtinë)

> [illegible] "VRELLA", Vrellë/Istog [illegible] (Zyra e [illegible] Ekonomike në Gjakovë)

Njësia e Ofertës

| Nr. i ofertës | Lokacioni, pasuria dhe veprimtaria | Ndërmarrja në likuidim | Depozita e Ofertës | Data/Orari e inspektimit |
|---|---|---|---|---|
| 01 | [illegible] Rr. 129/2 [illegible] (29 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 10.200 | Prej të Enjtes 15 Nëntor 2007 – Deri të Enjten 22 Nëntor 2007 |
| 02 | [illegible] Rr. 122/2 [illegible] (148 m² [illegible] 113 m² është objekti) [illegible] parcelat 8141 dhe 8142, Pejë | NT "17 Nëntori" | 10.150 | Njëjtë si më lartë |
| 03 | [illegible] Rr. 129/2 [illegible] (gjithsej 300 m² dhe objekt 845 m²) [illegible] parcelën 687 [illegible] Pejë | NT "17 Nëntori" | 10.000 | Njëjtë si më lartë |
| 04 | [illegible] Rr. 129/2 [illegible] (total 3000 m² [illegible] 00 m² [illegible]) [illegible] parcelën 698 | NT "17 Nëntori" | 10.250 | Njëjtë si më lartë |
| 05 | [illegible] Rr. 122/2 [illegible] Pejë | NT "17 Nëntori" | 9.900 | Njëjtë si më lartë |
| 06 | [illegible] Rr. 122/2 [illegible] Pejë | NT "17 Nëntori" | 9.850 | Njëjtë si më lartë |
| 07 | [illegible] Rr. 129/2 [illegible] [illegible] | NT "17 Nëntori" | 2.100 | Njëjtë si më lartë |

Rr. Adem Jashari [illegible] 2
30000 Pejë, Kosovë
Tel: +381 (0)39 432 579
Fax: +381 (0)39 431 564
web: www.kta-kosovo.org

**Orari i Punës: E Hënë – E Premte prej 8:30 deri 17:30**

Nëse jeni anëtar i një pakice etnike në Kosovë dhe keni nevojë për ndihmë për të para-regjistruar ose për të dorëzuar ofertën, ju lutem kontaktoni Zyrën Rajonale të paktën 10 ditë para Datës së Hapjes së Ofertave.

**Formularë dhe Dokumente** – Ofertuesit mund të tërheqin formularët e regjistrimit të ofertuesit, Rregullat e Tenderit dhe kushtet ligjore të shitjes nga faqja e internetit e Agjencisë: www.kta-kosovo.org nën titullin "Shitjet".

**Njoftimi i Kërkesave**

Personat që besojnë se kanë kërkesë të vlefshme në lidhje me asetet e sipërpërmendura ose entitetet që zotërojnë/zotëronin ato (duke përfshirë edhe pse nuk kufizohet vetëm te, (i) kërkesa nga personat që besojnë se janë pronarë të ligjshëm të ndonjë prej entiteteve ose aseteve të përmendura më lart ose të ndonjë pjese të tyre, ose pasardhësit e vlefshëm të tyre, ose (ii) kërkesa nga kreditorët) duhet të dorëzojnë një shkresë këto kërkesa, së bashku me një përshkrim të plotë dhe gjithë dokumentacionin mbështetës, në Zyrën Rajonale të AKM. Komisioni(et) i Likuidimit i emëruar nga AKM do të analizojë kërkesat e dorëzuara dhe dokumentet mbështetëse shoqëruese për të përcaktuar se kujt duhet t'i bëhen pagesat nga shuma e shitjes në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm. Duhet vënë në dukje se, sipas Ligjit të Zbatueshëm, është e mundshme që 20% e të ardhurave nga shitja do t'u paguhen [illegible] punonjësve të përshtatshëm, pasuar nga pronarët e tokës dhe kërkesat e siguruara, më pas kreditorët e pasiguruar, dhe më pas pronarët e entiteteve kur përcaktohet se entitetet janë transformuar në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe në mënyrë jo-diskriminuese.

AKM nuk do të vendosë mbi kërkesat si organ gjyqësor ose administrativ. [illegible] dorëzimi i kërkesave në AKM [illegible] AKM [illegible] kërkuesve [illegible] mundësinë të bëjnë [illegible] kërkesa e mundshme të dorëzohet edhe [illegible] për [illegible] Speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës, edhe të [illegible] në [illegible] me [illegible] gjyqësore të [illegible] AKM në [illegible].

Për formularët e kërkesave dhe detajet se si të dorëzohet kërkesa, shih [illegible] kosovo.org "Si të regjistrohet kërkesa" ose të tërhiqet formulari nga zyra e AKM. Kërkesat mund të dorëzohen po ashtu në zyrën e Shtylës IV të BE-së në Beograd, për të cilën adresa është Shtylla IV e BE-së, Zyra e Beogradit, Tolstojeva 47-49, 11000 Beograd, Serbi. Rregulloret përkatëse të UNMIK paraqiten të hollësishme në faqen e internetit të AKM "Shitjet".

3.2.1.4.

I pages + original



[illegible]

## [illegible] PËR SHITJE PUBLIKE

Shitja [illegible] PEJ 020[illegible]

[illegible] Agjencia Kosovare e Mirëbesimit [illegible] "Agjencia" [illegible] Agjencia [illegible]

[illegible] "Rregullave të Tenderit për Shitje [illegible]" [illegible] "Rregullat e Tenderit" [illegible]

[illegible] Ofertimi – [illegible] Ofertuesit duhet [illegible] Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit [illegible]

[illegible]

Periudha e Dorëzimit të Ofertave – [illegible] Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit [illegible] 10:00 deri 12:00 (ora e Prishtinës) më [illegible] Shkurt 2008.

Vendi(et) i Pranimit të Ofertave – Hotel Royal Aiks Pejë

[illegible] Hotel Royal Aiks [illegible] Pejë [illegible] 2008.

[illegible] Ofertuesve – [illegible] Tenderit.

Regjistrimi – [illegible]

[illegible] Ndërmarrjet Shoqërore [illegible]

1. N.T. "17 Nëntori" Pejë Fi. [illegible] (Gjykata Ekonomike në Gjakovë)

[illegible] Fi. [illegible]

[illegible] "17 November" Fi. [illegible]/92 (Gjykata Ekonomike Prishtinë)

[illegible] "17 November" [illegible] Fi. [illegible]/92 (Gjykata Ekonomike Prishtinë)

2. N.P. Fabrika e Birrës [illegible] Pejë (Gjykata Ekonomike në Gjakovë)

[illegible] Fi. [illegible]

PKG "Fabrika e Birrës" Fi. [illegible]/92 (Gjykata Ekonomike Prishtinë)

Njësitë e Ofruara

| Numri i njësisë | Përshkrimi i pasurisë dhe vendndodhja | Ndërmarrja e [illegible] | Depozita e Ofertës | Data/Orari e Inspektimit |
| --- | --- | --- | --- | --- |
| 01 | Shitorja [illegible] "Tekstil" ndodhet në ngastren kadastrale nr. [illegible] ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 10,000 | [illegible] 17 Janar 2008 – [illegible] 24 Janar 2008 |
| 02 | Shitorja [illegible] "[illegible]" ndodhet në ngastren kadastrale nr. [illegible]/2 (72 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 11,000 | [illegible] |
| 03 | Shitorja [illegible] "[illegible]" ndodhet në ngastren kadastrale nr. [illegible] ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | [illegible],000 | [illegible] |
| 04 | Shitorja [illegible] "[illegible]" ndodhet në ngastren kadastrale nr. 1016 ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | [illegible],000 | [illegible] |
| 05 | Shitorja [illegible] Galanteri [illegible] 2 ndodhet në ngastren kadastrale nr. [illegible] ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | [illegible],000 | [illegible] |
| 06 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren kadastrale nr. [illegible] (400 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 20,000 | [illegible] |
| 07 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren kadastrale nr. 1016 ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 12,[illegible] | [illegible] |
| 08 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren kadastrale [illegible] dhe 1016 ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 12,[illegible] | [illegible] |
| 09 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren nr. [illegible] ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 12,000 | [illegible] |
| 10 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren nr. [illegible] (75 m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 15,000 | [illegible] |
| 11 | Shitorja [illegible] ndodhet në ngastren nr. [illegible] ([illegible] m²), Pejë | NT "17 Nëntori" | 12,[illegible] | [illegible] |
| 12 | Kampion [illegible] 1917 | NP "Fabrika e Birrës Pejë" | 500 | [illegible] |

Pagesa: [illegible] Rregullave të Tenderit, Agjencia [illegible]

[illegible] (TVSH): TVSH [illegible]

Informacioni bankar: [illegible] Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK)

| | | |
| --- | --- | --- |
| Depozita e Ofertës | Emri i Xhirollogarisë: Numri i Llogarisë: | AKM [illegible] – Depozita e ofertës 1 000 [illegible] |

Depozita të [illegible] – [illegible]

[illegible]

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit [illegible]

Kontakti:
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
Zyra Rajonale në Pejë
[illegible]
[illegible] Pejë, Kosovë
Tel: [illegible]
Fax: [illegible]
Web: [illegible]

Orari i Punës: [illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

KOSOVO TRUST AGENCY

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

[illegible]

KOSOVO TRUST AGENCY

NJOFTIM PËR LIKUIDIM

[illegible]

KOSOVO TRUST AGENCY

NOTICE OF LIQUIDATION

[illegible]

KOSOVO TRUST AGENCY

NOTICE OF LIQUIDATION

[illegible]

Referenca e vendimit: DM 780/2022

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Drilan Hoxha Nr. 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 500 400, Fax: + 383 38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

VENDIM

për

Emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit

sipas nenit 13.1 dhe 13.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034,
ndryshuar me nenin 19 të Ligjit nr. 06/L-023

Emri i ndërmarrjes: PEJ139 17 Nentori

Duke u bazuar në nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) si dhe nenin 12 të Shtojcës së këtij Ligji, sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për fillimin e procedurës së likuidimit për ndërmarrjen e lartpërmendur, kjo ndërmarrje është vendosur në likuidim më datë 14/10/2005.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, bazuar në autoritetin e dhënë sipas nenit 11.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe sipas nenit 13 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me rastin e vendosjes së ndërmarrjes në likuidim e ka autorizuar Menaxhmentin e AKP-së që të emëroj anëtarët e Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore të lartpërmendur (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm të tyre). Sipas nenit 3 paragrafi 1.15 të Ligjit të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së nënkupton Drejtorin Menaxhues dhe Zëvendës Drejtorët Menaxhues të AKP-së kolektivisht dhe individualisht.

Me këtë vendim, personat në vijim emërohen zyrtarisht nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, anëtarë të Autoritetit të Likuidimit me të gjitha autorizimet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115.

Personat në vijim emërohen në Autoritetin e Likuidimit:

- Miftar Salihi, Kryesues (personel i OSHP-së);
- Olja Stojkovska, Anëtar (personel i OSHP-së);
- Kushtrim Thaqi, Anëtar - Zyrtar i Rastit (personel i AKP-së).

Ky Vendim për emërimin e anëtarëve të AL-së hyn në fuqi me datë 1 Nëntor 2022.

Arben Limani
Drejtor Menaxhues
Agjencia Kosovare e Privatizimit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE / MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI / MINISTRY OF PUBLIC SERVICES
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# ÇERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME / O PRAVIMA NA NEPOKRETNU IMOVINU / FOR THE IMMOVABLE PROPERTY RIGHTS

| | |
|---|---|
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office | Pejë/Peć/Pejë |
| Numri i Çertifikatës / Broj Certifikata / Certificate Number: | UL-71611071-03806 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 6/3/2010 - 12:31:19AM |
| Komuna / Opština / Municipality: | Pejë/Peć/Pejë |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | PEJË/PEĆ/PEJË |

A PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të Drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. ID<br>Lk. ID<br>ID No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Residence | Rruga<br>Ulica<br>Street | Nr.<br>Br.<br>No. | Kati<br>Sprat<br>Floor | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Part of scale | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedues<br>Posednik<br>Possessor | P.SH. NDËRMARJA TREGTARE -17 NËNTORI-PEJË | KCID1619601 | PEJË | | | | 1/1 | Nga/Od/From KCID |

B NJËSIA E PRONËS SË PALUAJTSHME - JEDINICE NEPOKRETNE IMOVINE   IMMOVABLE PROPERTY UNIT

| Nr. i Njësisë<br>Br. Jedinice<br>Unit No. | Llojet e Pronës<br>Vrsta Imovine<br>Property Class | Zona U/R<br>Zona U/R<br>Zone U/R | Shfrytëzimi Aktual<br>Aktuelna Upotreba<br>Actual Use | Vendi i quajtur<br>Zvano mesto<br>Place Name | Rruga<br>Ulica<br>Street | Nr.<br>Br.<br>No. | Kati<br>Sprat<br>Floor | Dhomat<br>Sobe<br>Rooms | Katet<br>Spratovi<br>Floors | Sipërfaqja (m2)<br>Površina m2<br>Area | L.Ndërtimore<br>D.Izgradnje<br>C.License | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 360 | - | |
| P-71611071-00245-5 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 519 | - | |
| P-71611071-00245-6 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 790 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.BISTRIČKA | | | | | | 6100 | - | |
| P-71611071-00566-0 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 383 | - | |
| P-71611071-00567-0 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 186 | - | |
| P-71611071-00568-0 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.M.TITA | | | | | | 232 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Urban<br>Urban<br>Urban | Tokë e ndërtimit<br>Gradjevinsko zemlisto<br>Construction land | M.TITA | | | | | | 60 | - | 16-2010-00<br>978<br>(4/14/2010) |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Urban<br>Urban<br>Urban | Tokë e ndërtimit<br>Gradjevinsko zemlisto<br>Construction land | UL.BRAT.JEDINST<br>VA | | | | | | 1340 | - | 16-2008-01<br>702<br>(9/18/2008) |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Urban<br>Urban<br>Urban | Tokë e ndërtimit<br>Gradjevinsko zemlisto<br>Construction land | UL.6 KONGRES | | | | | | 105 | - | 16-2010-01<br>226<br>(5/7/2010) |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | BRASTVO JEDIN | | | | | | 56 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | Tokë e ndërtimit<br>Gradjevinsko zemlisto<br>Construction land | UL.BRAT.JEDIN. | | | | | | 136 | - | 16-2007-03<br>029<br>(12/18/2007 |
| P-71611071-00996-0 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SPLITSKA | | | | | | 65 | - | -- |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL SPLITSKA | | | | | | 12 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SPLITSKA | | | | | | 10 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SPLITSKA | | | | | | 7 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SKOFLANSKA | | | | | | 61 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SPLITSKA | | | | | | 13 | - | |
| P-71611071-01135-0 | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.SPLITSKA | | | | | | 65 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Urban<br>Urban<br>Urban | Tokë e ndërtimit<br>Građevinsko zemlište<br>Construction land | UL.17 NOVEMBAR | | | | | | 70 | - | 16-2010-00 979 (4/14/2010) |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | UL.BRAT.JEDINST VO | | | | | | 21 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | BLAGOJE | | | | | | 1000 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | BLAGOJE | | | | | | 900 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | BLAGOJE | | | | | | 900 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Unknown<br>Unknown<br>Unknown | | BLAGOJE | | | | | | 900 | - | |
| [redacted] | Parcelë<br>Parcela<br>Parcel | Urban<br>Urban<br>Urban | Bujqësore<br>Poljoprivredne<br>Agriculture | KARAG.POLE | | | | | | 325 | - | 16-2008-02 053 (12/19/2008 |

Referenti / Referent / Referent

Drejtori / Director / Director

6/3/2010

Nr. Ref. BD-203/98

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 maj 2024 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m2; P-71611071-00245-2 me sipërfaqe prej 360 m2; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m2; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m2; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m2 dhe P-71611071-00568-0 232 m2 ZK Pejë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti - pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat kadastrale -71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m2; P-71611071-00245-2 me sipërfaqe prej 360 m2; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m2; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m2; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m2 dhe P-71611071-00568-0 232 m2 ZK Pejë pronë e NSh 17 Nëntori PEJ139.

Këto asete janë rast për heqje dorë për faktin se ngastrat që janë objekt i këtij vendimi në certifikatën e pronësisë nuk ka ndonjë evidencë për llojin e shfrytëzimit, mirëpo në bazë të raportit të vizitës në terren në këto parcela janë të ndërtuara objektet banesore që nga vitet e gjashtëdhjeta (60-ta), pra janë ndërtuar objekte banimi kolektiv dhe poashtu një pjesë e këtyre parcelave shfrytëzohet si rrugë dhe trotuar.

AL arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Agjencisë, për shkak se në tërë këto parcela janë ndërtuar objekte banesore për banim kolektiv në vitet e 70-ta. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "17 Nëntori" është pronare e objektit. Aaseti nuk është fitimprurës dhe duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, për këtë arsye, është vendosur për të hequr dorë nga ky aset. Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhurat të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 23 maj 2024

**Mentor Hyseni**
**Kryesues**
**Bordi i Drejtorëve**
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Memorandum për Bordin e Drejtorëve**

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Bordin e Drejtorëve, Agjencia Kosovare e Privatizimit | |
| Përmes: | Arben Limani, Drejtor Ekzekutiv - AKP | Nënshkrimi/Data 16/05/2024 |
| Prej / përgatitur nga: | Miftar Salihi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit i PEJ139 NSh "17 Nëntori" (Në likuidim) | Nënshkrimi/Data 15.05.24 |
| Lënda: | **Heqja Dorë nga Pronësia e Aseteve me nr. P-71611071-00245-5; P-71611071-00245-6; P-71611071-00566-0; P-71611071-00567-0 dhe P-71611071-00568-0 në pronësi të NSh "17 Nëntori" PEJ139** | |
| Data: | 15 maj 2024 | |

1. **Qëllimi i Memorandumit**

Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për heqje dorë nga pronësia e parcelave nr. P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m$^2$; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m$^2$; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m$^2$; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m$^2$ dhe P-71611071-00568-0 232 m$^2$ ZK Pejë pronë e NSh "17 Nëntori" PEJ136.

2. **Përmbledhja dhe historiku**

Ngastrat kadastrale nr. P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m$^2$; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m$^2$; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m$^2$; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m$^2$ dhe P-71611071-00568-0 232 m$^2$ ZK Pejë që janë objekt i kësaj kërkese në certifikatën e pronësisë nuk ka ndonjë evidencë për llojin e shfrytëzimit, mirëpo në bazë të raportit të vizitës në terren në këto parcela janë të ndërtuara objektet banesore që nga vitet e gjashtëdhjeta (60-ta), pra janë ndërtuar objekte banimi kolektiv dhe poashtu një pjesë e këtyre parcelave shfrytëzohet si rrugë dhe trotuar.

Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk ka informata për ekzistimin e ndonjë vendimi për lejen e ndërtimit apo dhënien në shfrytëzim të këtyre banesave, por në bazë të informatave të pakonfirmuara zyrtarisht këto parcela në vitet e shtatëdhjeta janë shpronësuar nga Komuna dhe i janë dhënë një NSh-je tjetër, saktësisht NSh Izrgandnja që të bëjë ndërtimin e objekteve banesore për nevojat e punëtorëve por ndryshimet kadastrale asnjëherë nuk janë kryer.

3. **Arsyetimi**

Në Ngastrat kadastrale nr. P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m$^2$; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m$^2$; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m$^2$; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m$^2$ dhe P-71611071-00568-0 232 m$^2$ ZK Pejë janë ndërtuar ndërtesa për banim kolektiv.

Këto parcela, siç mund të vërehet edhe nga raporti i vizitës në terren përfshijnë në tërë sipërfaqen e tyre, hapësirën mbi të cilën janë ndërtuar objekte banesore dhe hapësira të rrugës përrëth këtyre ndërtesave.

Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se në këto parcela nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së, për shkak se në tërë këto parcela janë ndërtuar objekte banesore për banim kolektiv në vitet e 70-ta. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk posedon ndonjë dëshmi apo dokument pronësor që do të provonte faktin që NSh "17 Nëntori" është pronare e objektit. Duke qenë në këtë gjendje është e pa mundur që të shitet apo pronësia të realizohet në forma të tjera, dhe për këtë arsye, ne po kërkojmë leje për të hequr dorë nga këto asete.

Për më tepër, pas heqjes dorë nga kjo parcelë, kjo parcelë do të kalojë në pronësi të organi publik kompetent në territorin në të cilin ndodhet paluajtshmëria, saktësisht në emër të KK Prishtinë, sipas nenit 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i cili parasheh që *"Në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria. Autoriteti publik kompetent e fiton të drejtën e pronësisë në këtë send me regjistrimin e të drejtës së pronësisë ne regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri"*.

Sipas praktikës së pronës shoqërore, toka brenda zonave urbane ishte e dedikuar për ndërtimin e objekteve të banimit dhe ndërtesave, dhe kategorizohej si "tokë ndërtimore". Qytetarët fitonin të drejtën e pronësisë mbi objektin banesor por, të garantuar e kishin vetëm të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të tokës ndërtimore mbi të cilën ishte ndërtuar objekti[1].

Në bazë të nenin 9 par. 1 të Projektligjit për Tokën Ndërtimore (projektligj i aprovuar në mbledhjen e 42-të të Qeverisë së Kosovës me vendimin Nr. 04/42 të datës 27.10.2021) *"Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi private apo publike"* lidhur me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Autoriteti i Likuidimit konsideron që kjo parcelë duhet të bartet në emër të KK Pejë pasi që nga ana e Autoritetit të Likuidimit/AKP-së nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv dhe është pastaj obligim i Komunës që në përputhje me legjislacionin aktual të ju ofrojë siguri juridike edhe banorëve të ndërtesës të ndërtuar në parcelën objekt i kësaj kërkese. Për më tepër është përgjegjësi e Komunës që të bëjë azhurnimin e të dhënave kadastrale sa i përket llojit të shfrytëzimit të parcelave.

Në këto raste, siguria juridike për pronarët/shfrytëzuesit e njësive banesore është e garantuar edhe në rast se ndërtesa shkatërrohet ose zhvlerësohet, ku pronari/pronarët e ndërtesës kanë të drejtën e përparësisë për të ri-ndërtuar ndërtesën. Vetëm nëse e drejta e përparësisë nuk është përdorur, toka kthehet në autoritetin administrativ të komunës e cilat pastaj mund të japë të drejtën e përdorimit një personi tjetër[2].

Poashtu, nuk mund të bëhet bartja e pronësisë së parcelave në fjalë në emër të personave privat, për arsye se ndërtesa është e destinuar për banim kolektiv dhe nuk posedojmë ndonjë dëshmi që ndonjë personi i është dhënë me vendim e drejta mbi shfrytëzimin e përhershëm të tokës ndërtimore apo ka të drejtën e pronësisë në ndërtesën e ndërtuar në tokën ndërtimore, në të cilën ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm, sipas ndonjë pune tjetër juridike siç është dhënia në shfrytëzim të përhershëm e tokës ndërtimore, me kompensim apo pa kompensim, për ndërtimin e ndërtesave.

---

[1] Qeveria e Republikës së Kosovës, *Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë*, Dhjetor 2016, fq. 22.
[2] Qeveria e Republikës së Kosovës, *Memorandum Shpjegues për Projektligjin për Tokën Ndërtimore*, fq. 3.

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

4. <u>Rekomandimi nga Autoriteti i Likuidimit:</u>

Kërkojmë nga Bordi i Drejtorëve të miratojë propozimin e AL-së për të hequr dorë nga aseti në fjalë, me qëllim që AL të mund të kërkojë miratim përfundimtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 18, paragrafit 3.1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

5. <u>Baza Ligjore</u>

- Neni 15.1 i Ligjit të AKP-së (Përgjegjësitë e Bordit të AKP-së);
- Neni 18.3.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së (Përgjegjësitë dhe autorizimet e përgjithshme të Autoritetit të Likuidimit);
- Rregullore Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve;
- Neni 42 par. 2 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore;
- Neni 3.10.4 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politika dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore;

**VENDIM:**

**I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet P-71611071-00245-5 me sipërfaqe prej 519 m²; P-71611071-00245-6 me sipërfaqe prej 790 m²; P-71611071-00566-0 me sipërfaqe prej 383 m²; P-71611071-00567-0 me sipërfaqe prej 186 m² dhe P-71611071-00568-0 232 m² ZK Pejë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

**II. Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

**III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

<u>**Shtojcë:**</u>

1. Kërkesa e drejtuar Dhomës së Posaçme për heqjen dorë nga aseti.